

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI JURIDIK
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ
FACULTY OF LAW

STUDIME PASDIPLOMIKE –CIKLI I DYTË

TEZA

KRIMINALITETI EKOLOGJIK NË RAJONIN E POLLOGUT NË PERIUDHËN

2010-2015

KANDIDATI:

Arsim Qazimi

MENTORI:

Prof.Dr.Jeton Shasivari

Tetovë, 2018

Përmbajtja

HYRJA	4
LËNDA E HULUMTIMIT	6
QËLLIMET E HULUMTIMIT	7
HIPOTEZAT.....	8
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	8
RËNDËSIA E PUNIMIT.....	9
KAPITULLI I PARË.....	10
KUPTIMI DHE ASPEKTI JURUDIK I KRIMINALITETIT EKOLOGJIK.....	10
1. Historiku dhe Kuptimi i kriminalitetit ekologjik.....	10
1.2. Aspekti juridik i kriminalitetit ekologjik.....	14
1.2.1.Konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare lidhur me krimin ekologjik.....	15
1.2.2 Kushtetuta dhe ligjet vendore për mbrojtjen e ambientit jetësor	17
KAPITULLI I DYTË	21
FENOMENI I KRIMIT EKOLOGJIK NË RAJONIN E POLLOGUT	21
2.1 Vëllimi dhe struktura e kriminalitetit ekologjik në rajonin e Pollogut	21
2.2 Disa veçori themelore të kriminalitetit ekologjik në rajonin e Pollogut	27
2.2.1 Zhvillimi industrial dhe kriminaliteti ekologjik	29
2.2.2 Karakteristikat kohore dhe sezonale të kriminalitetit ekologjik	33
2.2.3 Karakteristikat regjionale të kriminalitetit ekologjik	35
KAPITULLI I TRETË.....	36
FORMAT DHE SHKAQET E PARAQITJES SË KRIMINALITETIT EKOLOGJIK NË RAJONIN E POLLOGUT.....	36
3.1 Format e kriminalitetit ekologjik në rajonin e Pollogut.....	36
3.1.1 Ndotja e ajrit.....	38
3.1.2 Ndotja e tokës.....	42
3.1.3 Ndotja e ujit.....	45
3.2 Shkaqet e paraqitjes së kriminalitetit ekologjik.....	48
3.2.1 Kryerësit e veprave penale kundër mjedisit dhe natyrës.....	49
3.2.2 Migrimet e popullsisë fshat-qytet	50

3.2.3 Mjedisi shoqëror	51
3.2.4 Kushtet e vështira ekonomike sociale	52
KAPITULLI I KATËRT	54
FORMAT E LUFTIMIT DHE MASAT PËR PARANDALIMIN DHE SANKSIONIMIN E KRYERËSVE TË KRIMINALITETIT KUNDËR AMBIENTIT	54
4.1 Metodat më efikase në parandalimin e krimit ekologjik.....	54
4.2 Masat parandaluese ndaj veprave penale kundër mjedisit	62
4.4 Roli i policisë në parandalimin e kriminalitetit ekologjik.....	68
4.5 Politika e dënimit ose sanksionet kundër krimit mjedisor	72
KONKLUZIONET	75
BIBLIOGRAFIA	79

HYRJA

Kriminaliteti ekologjik është një term të cilin çdo ditë e më tepër po e dëgjojmë më shumë nëpër media, ndërkaq si fjalë është shumë e kuptueshme, mirëpo si problem për shumicën e njerëzve është i pa rëndësishëm dhe nuk krijon frikën që në këtë rast do të shkaktonin krimet tjera.

Si kërcënim për jetën e njeriut ky kriminalitet ka nis të studiohet shumë më vonë për dallim me disa krime tjera, që domethënë është një problem relativisht i ri për hulumtuesit mirëpo rrënjët i ka shumë më herët kurse pasojat janë shfaqur pas një kohe, për këtë shkak edhe hulumtuesit dhe literatura janë të pakta në këtë fushë.

Në këtë punim do të përmbledhim të dhënat nga institucionet dhe politikat internacionale që kushtëzojnë legjislacionin tonë, mendimet e ekspertëve botërorë për këtë lloj kriminaliteti dhe zgjidhjet afatshkurte dhe afatgjate për parandalimin dhe rikuperimim e këtyre dëmeve.

Sëmundjet vdekjeprurëse dhe lloje të ndryshme të problemeve shëndetësore që kohën e fundit janë shtuar dhe ndërlikohja e tyre me ndotjen e ambientit shihet qartë dhe do të mundohemi të hulumtojmë në këtë punim.

Kurse vështrim të posaçëm do të japim për aspektin kriminologjik të këtij krimi gjegjësisht etiologjinë dhe fenomenologjinë kriminale, shkaqet që nxisin këtë lloj krimi, pasojat në jetën e njeriut si dhe format e ndryshme të paraqitjes të cilat janë sfida e vërtetë për hulumtuesit dhe ndjekësit institucional të këtij fenomeni.

Në Republikën e Maqedonisë ekzistojnë ndotës të shumtë të mjedisit jetësor, mirëpo një nga më të mëdhenjtë gjendet në territorin e Pollogut gjegjësisht në fshatin Jegunovcë 10 kilometra larg Tetovës një fabrikë me emrin aktual “Jugohrom Ferroalloys”, kjo kompani daton që nga viti 1952 së pari me emrin “Silmak” si një kompani shtetërore, e cila ishte punëdhënësi më i madh në këtë rajon, në vitin 2010 kjo kompani u privatizua nga gjiganti rus “Camelot grup” me punën e tyre kjo kompani cilësohet nga organizata botërore e shëndetësisë si shkaktar i helmimit të tokës dhe ajrit, që si pasojë në këtë rajon është rritur numri i të sëmurëve nga

kanceri, sëmundjeve të zemrës, infeksionet respiratore etj. Ndotja e ajrit u konfirmua nga Ministria e Mjedisit dhe planifikimit hapësinor, ku koncentrimi i grimcave pm10 në ajër shkonte gjatë dimrit deri 10 herë më lart se kufiri i lejuar.

Poashtu edhe transporti cilësohet si një problem në lidhje me ndotje e ajrit në periudhën pas viteve 2000 numri i automjeteve u rrit dukshëm në krahasim me vitet e kaluara, kurse cilësia e tyre nuk kontrollohej kategorikisht nga ana e kompetentëve.

Një numër i madh i banorëve të zonave rurale dhe urbane në rajonin e Pollogut përdorin për ngrohje lëndët djegëse të ngurta (biomas dhe thëngjill) nga mungesa e një sistemi ekonomik të ngrohjes, qytetarët janë të obliguar që të përdorin alternativa të rrezikshme dhe me masa jo ripërtëritëse.

Në Maqedoni nga ndotja çdo vit vdesin përafërsisht 1000 deri 1500 njerëz, për atë shkak secili i katërti ose i pesti infarkt apo goditje në tru ndodh për shkak të ndotjes kurse këta numra do të rriten në qoftë se nuk ndërmerret asgjë në lidhje me këtë dukuri, kjo ishte e cekur në konferencën shkencore për ndotjen në Maqedoni të mbajtur nga shkencëtarët, e përkrahur nga ambasadat e Gjermanisë dhe Amerikës. Çdo ditë qytetarët e Maqedonisë thithin ajrin e ndotur të dalur nga deponitë dhe industritë e vendit kurse ndotja arrijnë kulminacionin gjatë sezonit të dimrit ku në skenë del edhe djegja e drunjëve ku në ajër emitohen një numër i madh i grimcave helmuese, të cilat në kombinim me materialet toksike përshembull grimcat Pm shkaktjnë sëmundje të ndryshme për arsye se ato qëndrojnë në mjegulla për një kohë të gjatë dhe thithen çdo ditë nga njerëzit.

Aktivitetet industriale dhe urbane janë burimet më të mëdha të ndotjes me materie helmuese. Megjithatë lëndët djegëse fosile qoftë të kontrolluara (amvisërit) ose të pa kontrolluara (deponitë etj.) mbeten burimi kryesor i ndotjes. Nga këto lloj burime përveç se në fazën e fundit fitohet pluhuri aty ka shumë substanca toksike të cilat të gjitha emitohen në ajër dhe pas thithjes njerëzit fitojnë infeksione të ndryshme, thot Stafillov.

Dr. Dragan Gjorgjev nga Instituti i Shëndetit Publik thotë se në Maqedoni ka ndotje të madhe dhe atë rreth 10 herë më të mëdha se kufijtë e lejuar nga Bashkimi Evropian dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë e cila ka efekt në sëmundjet akute dhe kronike tek njeriu. Sëmundjet akute janë të kombinuara me viruse dhe ne kemi kërkesa të mëdha për

asistencë në spital dhe ambulancë. Megjithatë, në këto kushte dhe vdekshmëria është rritur, ne kemi rritur majat e vdekshmërisë në ato periudha kur ndotja e ajrit është rritur dhe kur ne kemi temperatura të ulëta në të njëjtën kohë. Vdekshmëria në pacientët kronikë është rritur, dhe sëmundjet kardiovaskulare dhe malinje janë në rritje. Ky trend do të vazhdojë nëse nuk do të fillojmë së punuari në mënyrë të sinkronizuar - thotë Gjorgjev.

Duhet menjëherë organet kompetente të hartojnë plane reale për përmisimim e ndotjeve, që u shkurtojnë jetën qytetarëve të cilët të pafajshëm apo edhe të pa vetëdijshëm po ngulfaten në tmerrin e mos funksionimit të sistemit ekologjik.

LËNDA E HULUMTIMIT

Në këtë punim në fillim sipërfaqësisht do të mundohemi të shpjegojmë kuptimin e kriminalitetit ekologjik dhe rëndësinë që duhet t'i jepet këtij fenomeni që preokupon njerëzimin në botën e globalizuar dhe me çfarë metodash ato mundohen që të parandalojnë këtë krim, që shpie në katastrofë globale, kurse në hollësi do të mundohemi t'i qasemi problemit që ka marrë përmasa të mëdha në kohën e fundit në shtetin tonë kurse vështirë të posaçëm do t'i japim rajonit që mund të jetë një nga më të ndoturit në botë për ajrin përkohësisht, gjithashtu do të hulumtohen këto probleme nga aspekti juridik si ligjet nacionale dhe konventat ndërkombëtare respektohen apo nuk përfillen nga ana e shtetit. Lëndë studimi do të jenë format e paraqitjes së këtij krimi dhe cilat janë më aktuale në rajonin tonë, si dhe nga cilat shkaqe ato paraqiten dhe kush pëson më shumë në këto lloje krimesh që për shumicën e popullatës nuk duken aq të rrezikshme në përfytyrimin e tyre të parë mirëpo pasojat e saj vijnë në mënyrë permanente, do të studiohen llojet e dëmeve që janë shkaktuar dhe që rrezikojnë të ardhmen tonë.

Se çfarë masash do të duhet të merren nga ana e shtetit, për zvoglimin e këtyre lloje krimesh dhe çfarë aktualisht janë marrë, çfarë nuk respektohet dhe si duhet të angazhohemi ne, që këtë problem ta zgjidhim do të jenë lëndë studimi. Një theks i veçantë do të vihet mbi bashkëpunimin e organeve shtetërore me organizatat e ndryshme me qëllim të luftimit dhe parandalimit sa më të suksesshëm të këtij kriminalitetit të rëndë. Lëndë hulumtimi për këtë punim do të jenë edhe: aktet normative si dhe politikat e institucioneve për zbatimin e ligjit;

rregulloret e punës së institucioneve të zbatimit të ligjit, raportet monitoruese, projektet shkencore të cilat udhëzojnë në zbatimin e standarteve më të mira në lëminë e mbrojtjes së ambientit, do të hulumtojmë për numrin e rasteve të gjykuara nga ana e gjykatës dhe aktgjykimet të cilat u janë shqyptuar kryersëve të këtyre veprave, literatura shkencore e autorëve të librave të ndryshëm që i përgjigjen kësaj teme dhe burimet nga interneti. Kjo literaturë do të na mundësojë për të zbërthyer këtë temë dhe për të nxjerrë përfundimet e duhura.

QËLLIMET E HULUMTIMIT

Me këtë hulumtin tentohet të arrihen përfundime, që do të jenë bindëse për përmasat e këtij kriminaliteti në vend, që me statistika dhe analiza të bëhet krahasimi i pasojave që dalin prej tij.

Kurse qëllimi kryesor është që të rritet vetëdija se në këtë ambient jetojnë edhe të varfërit edhe të pasurit edhe ata që janë përgjegjës në menyrë direkte për këto pasoja edhe ato që heshtin ndaj këtyre krimeve.

Në këtë punim do të mundohemi të paraqesim të dhëna statistikore për numrin e viktimave që shkakton ky kriminalitet, numrin e sëmundjeve kancerogjene dhe vdekjeprurëse që përballen njerëzit kohën e fundit ,ndryshimet klimatike që vijnë si pasojë e ndotjes së ajrit me gazra helmuese nga ana e fabrikave dhe djegieve të mbeturinave si dhe ndotja nga gazrat që nxjerrin automobilat, dëmtimi i florës dhe faunës si dhe helmimi i tyre me anë të pesticideve të ndryshme kancerogjene që çdo ditë konsumohen nga qytetarët.

Do të mundohemi që të gjejmë bazën e neglizhencës nga ana e organeve kompetente për parandalimin e këtij fenomeni dhe si ka ardhur deri te ikja nga përgjegjësia e atyre kriminelëve.

Ky punim ka qëllim që t'i bëjë njerëzit të ndërgjegjshëm, që natyra nuk është një burim pa kufi dhe duhet bërë kujdes për të, sepse në këtë mënyrë bëjmë kujdes për veten tonë.

Mund të përmendim shumë raste kur njeriu vepron kundër natyrës, por pasojat i kthehen atij vetë, si bumerang. Masat që duhet të merren kundër agresioneve që vijnë nga aktiviteti njerëzor i paligjshëm për fitime individuale në kurriz të natyrës.

HIPOTEZAT

Mendimin tim lidhur me këtë kriminalitet e paraqes në bazë të asaj se interesat vetijake të përkohëshme që mbizotrojnë në kohën moderne janë aq të mëdha, sa që nuk lënë hapësirë për ambientalistët që ndikojnë tek organet kompetente shtetërore, sepse presioni më i madh tek ta bie nga këta lloj individësh dhe kompanishë gjigante që bëjnë ç'natyrizimin e planetit Tokë me politikat e tyre materialiste, këtu mund të flitet edhe për krim të organizuar të njerëzve me pozita të larta udhëheqëse.

Në mënyrë të qartë mendojmë se tymi nga oxhaqet e fabrikës më të madhe në rajon “Jugohrom Ferroalloys” ka sjellur për vite me radhë krahas ndotjeve tjera sëmundje të pashërueshme tek njerëzit e kësaj rrethine, si dhe ndotjen e tokës pjellore përreth.

Kurse shtimi i numrit të makinave të importuara nga jashtë vendit, si dhe favorizimi i shtetit me uljen e taksave për makinat e vjetra dhe lejimin e tyre apo mbushjen Rajonit të Pollogut me mbeturinat e Evropës, ka bërë që në vend të mbretëroj një kaos i madh në komunikacion, që për fat të keq ne e thithim ajrin e tyre të helmuar.

Tjetër mendim mund të themi se shtimi hapësirave të gjelbëruara dhe mbjellja e fidanëve duhet të jenë në planet e komunave përkatëse, si dhe një punë e palodhëshme e inspektorëve të ekologjisë do të ndikonte.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Në këtë punim do të mundohemi që në mënyrë më të mirë të mundëshme të përdorim metodat më të reja dhe më efikase për studimin dhe zbërthimin e këtij kriminaliteti, metoda të cilat janë të verifikuara dhe pranuar nga shkencat moderne në luftën e parandalimit dhe luftimit të krimit.

Një nga metodat bashkëkohore është ajo e evidencave dhe statistikave që do të përdoret për të krahasuar të dhënat nga institucione dhe hulumtime të ndryshme në vend, me anë të kësaj metode janë arritur rezultate të mira duke e përdorur në shkencë.

Në vazhdim do të përdorim metodën e analizës dhe vlerësimit të lëndëve mbi viktimat lidhur me studimin dhe zbardhjen e fenomenit të viktimizimit e sidomos lidhur me shpjegimin e shkaqeve të tij, në këtë drejtim me shumë rëndësi janë konstatimet e organeve të drejtësisë dhe mjekësisë.

Do të mundohemi që me metodën historike komperative të bëjmë dallimin në mes të asaj se si ka qenë gjendja dhe ligjet kundër ambientit në periudha të ndryshme kohore dhe si kanë ndryshuar, si dhe të bëjmë dallimin se sa aktgjykime kanë pasur në të kaluarën dhe sa ka tani, në kohën më moderne lidhur me krimin ekologjik në përgjithësi, kurse kujdes të veçantë do t'i japim rëndësisë që ka pasur ambienti jetësor në të kaluarën dhe si ka ndryshuar kjo me kalimin e kohës si dhe shtimin e popullsisë dhe nevojave personale.

RËNDËSIA E PUNIMIT

Kriminaliteti si dukuri negative shoqërore e theksuar në të gjitha vendet e botës, dhe në veçanti kriminaliteti ekologjik, natyrisht se kërkon angazhim për trajtim të veçantë nga ana e organeve shtetërore të vendeve përkatëse por edhe nga prizmi i mekanizmave ndërkombëtare të sigurimit në mënyrë që si dukuri të pengohet dhe të luftohet. Ky punim para se gjithash ka rëndësinë e vet të veçantë pasi që do të ngërthejë në vete tematikë të ndryshme në të, mirëpo rol të veçantë do t'i kushtohet rolit të institucioneve, në parandalimin e këtij lloj krimi në shoqëri, si dhe garantimin e kësaj të drejte të mbrojtur me kushtetutë, që në mënyrë të barabartë qytetarët të shfrytëzojnë të mirat që i ka dhënë natyra.

Punimi do të nxjerrë rezultatet, përfundimet dhe rekomandimet e duhura, që do të shërbejnë për avancimin dhe trajtimin e saktë institucional të dukurive negative kriminale duke u munduar, që në të ardhmen gjithnjë e më tepër të zvogëlohet kriminaliteti ekologjik. Mirëpo, për të arritur këtë rezultat kërkohet bashkëpunimi më i mirëfilltë i të gjitha organeve, strukturave mbrojtëse dhe shfrytëzimi i masave më adekuate për të luftuar këtë dukuri negative, ku rënia e këtij krimi do të sjellë më tepër harmoni dhe zhvillim të qëndrueshëm tek qytetarët që të mund të avancohet më tepër edhe siguria e tyre edhe pasardhësve të tyre.

KAPITULLI I PARË

KUPTIMI DHE ASPEKTI JURUDIK I KRIMINALITETIT EKOLOGJIK

1. Historiku dhe Kuptimi i kriminalitetit ekologjik

Ekologjia përfshinë në vete të gjithë procesin e jetës së njeriut dhe qënieve të tjera që jetojnë në planetin Tokë, duke nisur që nga lindja, zhvillimi dhe vdekja. Dhe duke pasur parasysh këtë mund të themi se çdo qenie është në relacion me natyrën dhe varet plotësisht prej kushteve që na ofron vetë ajo. Deri para disa dekadave në përgjithësi nuk është menduar si problem pakësimi i këtyre të mirave jetësore, sepse është konsideruar se natyra është një thesar i pashterur dhe gjegjësisht nuk mund të harxhohet. Mirëpo në vitet e fundit shkenctarët gjatë hulumtimeve të tyre kanë mohuar të njëjtën dhe se kanë konstatuar se ambienti jetësor po shkon drejt shkatërimit dhe po harxhohen resurset natyrore, si pasojë e moskujdesit dhe neglizhencës nga vetë njeriu, mjafton të përmenden vetëm disa pasoja të kësaj neglizhence si shkatërimi dhe dëmtimi i mbështjellësit të ozonit mbi Arktik, zhdukja e specieve të ralla, helmimi me pesticide të ndryshme të tokës dhe ajrit etj.

Ashtu si të gjitha fazat e mësimin, shkenca e ekologjisë ka pasur një zhvillim gradual. Shkrimet e Hipokratit, Aristotelit dhe filozofë të tjerë të lashtë në Greqi në mënyrë të qartë përmbajnë referenca për tema ekologjike. Megjithatë, grekët nuk kanë një fjalë të posaçme për ekologjinë. Fjala ekologji është me origjinë të kohëve të fundit, duke qenë e propozuar së pari nga biologu gjerman Ernst Haeckel në vitin 1869. Haeckel ka definuar ekologjinë si "studimi i mjedisit natyror duke përfshirë marrëdhëniet e organizmave me njëri-tjetrin dhe në rrethin e tyre" (Haeckel 1869). Para kësaj, gjatë një rilindje biologjike në shekujt XVIII dhe XIX, shumë studiues kanë kontribuar në këtë temë, edhe pse fjala ekologjia nuk ishte në përdorim.

Mirëpo nuk mund të themi se problemi i ekologjisë nuk është menduar aspak në lashtësi, këtë më së miri na tregojnë disa vepra ku janë përmendur problemet ekologjike si për shembull Avicenna në veprën e tij "Kanuni i medicinës" viti 904 ka theksuar temat e ushqimit të njeriut, kushtet klimatike, uji si domosdoshmëri etj. Parime ekologjike mund të gjenden edhe në Kinën e lashtë, në Indi, Egjipt si dhe në Greqin dhe Romën e lashtë.¹

¹ Ristevski K. Davidovski B. "Ekolosko pravo", Studentski sbor, Shkup, 1997 fq.11

Ekologjia ishte me interes praktik në fillim të historisë njerëzore. Në shoqërinë primitive, të gjithë individëve u ishte e nevojshme të dinë mjedisin e tyre se çfarë është, për të kuptuar forcat e natyrës bimët dhe kafshët rreth tyre, për të mbijetuar. Fillimi i civilizimit, në fakt, përkoi me përdorimin e zjarrit dhe mjete të tjera për të ndryshuar mjedisin. Për shkak të arritjeve teknologjike, njerëzit duket se janë të mvarur më pak me mjedisin natyror për nevojat e tyre të përditëshme; shumë prej nesh harrojmë varësinë tonë të vazhdueshme në natyrë për ajër, ujë, dhe në mënyrë indirekte, ushqimi, për të mos përmendur asimilimin e mbeturinave, rekreative, si dhe shumë shërbime të tjera të furnizuara nga natyrë.

Çuditërishtë gjatë viteve 1970 gjithëkush papritur fillon të brengoset për mjedisin jetësorë, për ndotjen, zonat natyrore, rritjen e popullsisë, ushqimit dhe konsumin e energjisë, dhe diversitetin biologjik, siç tregohet nga reportazhi i gjërë i bërë për shqetësimet mjedisore në shtypin popullor. Vitet 1970 janë shpesh të referuara si "dekada e mjedisit", e iniciuar më parë me "Ditën e Tokës", më 22 prill 1970. Më pas, në vitin 1980 dhe 1990, çështjet e mjedisit janë shtyrë në prapavijë politike nga shqetësimet për marrëdhëniet njerëzore probleme të tilla si krimi, të luftës së ftohtë, buxhetet qeveritare, dhe mirëqenien. Në vitet në vazhdim ekologjia shihet e ndarë nga biologjia dhe i kushtohet një kujdes i veçantë, sidomos në ruajtjen e mjediseve dhe specieve të posaçme me inkriminimin në ligje dhe konventa duke detyruar në respektimin e tyre.

Sa i përket kuptimit të kriminalitetit ekologjik ka shumë autorë të cilët kanë definuar këtë dukuri, mirëpo ne do të përmendim disa prej tyre të cilët do të na ndihmojnë që të kuptojmë atë si të tërë duke pasur parasysh se kjo dukuri prek shumë sfera të jetës dhe shumë qenie jo vetëm njeriun, domethënë kemi dy lloje viktimash edhe trajtimi është bërë shumë më i gjërë dhe shumë autorë e kanë përkufizuar në mënyra të ndryshme si “Kriminologjia e gjelbërt” “Kriminaliteti kundër mjedisit jetësor” “Krimi kundër natyrës” etj.

Çfarë nënkuptojmë me termin 'kriminologji e gjelbërt'? Në nivelin e tij më abstrakt, kriminologjia e gjelbërt i referohet studimit të këtyre krimeve kundër njerëzimit, kundër mjedisit (duke përfshirë edhe hapësirën) dhe kundër kafshëve jo-njerëzore kryer si nga institucionet e fuqishme (p.sh. qeveritë, korporatat transnacionale, aparaturo ushtarake) dhe gjithashtu nga njerëz të zakonshëm. Arsytet për mos marrëveshjet në përcaktimin e termit të krimi mjedisor ndryshojnë nga dallimet teorike dhe abstrakte të koncepteve politike për shkak të interesave të

ndryshme të vendeve të veçanta. Në këtë punim ne do të përdorim termin Kriminalitet kundër mjedisit dhe natyrës si dhe Krim ekologjik. Do të angazhohemi më shumë që të hulumtojmë krimin ekologjik në aspektin njeri, domethënë njeriu si viktimë e këtij krimi mirëpo më pak qeniet jo njerzore, edhe pse shumë pak kjo dukuri mund t'i ndaj viktimat e tij, sepse kjo dukuri atakon të mirat e përgjithshme.

Me ndotje nënkuptojmë ndryshimin kualitativ dhe kuantitativ të vecorive fizike, kimike dhe biologjike të komponentëve kryesorë (ajrit, ujit, tokës, ushqimit etj) të ambientit jetësorë, i cili sjell drejt çregullimin e ligjshmërive të ekosistemit, të bazuar në mekanizmat e vetë rregullimit.²

Kurse në shumë vende sikur edhe në vendin tonë në ligjislacion janë të përkufizuara këto krime si Krime kundër ambientit jetësorë, mirëpo çfarë kuptojmë me ambient apo mjedis jetësor. Mjedisi apo ambienti jetësor është hapësira në të cilën qeniet e gjalla kalojnë jetët e tyre në harmoni dhe të lidhura ngushtë në relacion me njëra tjetrën. Mjedisi është një sistem dinamik kompleks nën ndikim të shumë faktorëve teknologjik, biologjik dhe social. Krimi mjedisor është klasifikuar nga shumë autorë (Kanduč, 1994; Croall, 1992; Pečar 1996; Reid, 2004; Dobovšek, 1997; Sutherland, 1983 Poveda, 1994; etj). Krim të jakës të bardhë, ndërsa disa autorë të tjerë (Emmons, 2000, Siegel, 2001) e kanë klasifikuar atë si krim të biznesit.³

Kriminalitet ekologjik në kuptim të gjërë kuptojmë ato veprime njerëzore apo ndodhi negative të llojllojshme që paraqiten në shoqëri që kërcënojnë, rrezikojnë dhe dëmtojnë vlerat elementare njerëzore. Të gjithë krimet janë të rënda po ashtu të ndërlikuara dhe të rrezikshme, por duke pasur parasysh pasojat e tyre kriminaliteti ekologjik përshfaqshinë një hapësirë pak më të gjërë sepse në pasojat e tyre nuk mund të vëndoset kufij. Ato tejkalojnë të gjithë barrierat dhe për këtë arsye meritojnë vështrim dhe kujdes të posaçëm, si dhe bashkëpunim më të gjërë në luftimin dhe parandalimin e tij.

Ndotja e ambientit ka filluar të merr përmasa globale viteve të fundit me fillimin e zhvillimit industrial, shfrytëzimin e resurseve natyrore për nevojat kohore zhvillimi gjithnjë e më i madh i teknologjisë bashkohore dhe duke pasur parasysh fitimet maramëndëse që vijnë nga përpunimi i tyre, njeriu ka vënë në rend të parë përfitimin material përpara mirëqënies dhe

² Latifi Vesel, "Kriminalistika", 2011, fq. 449

³ Crimes against the Environment: Green Criminology and Research Challenges in Slovenia 2011 fq. 8

harmonisë globale. Gjatë këtyre proceseve institucionet kompetente mbyllin sytë dhe nuk respektojnë rregulloret sepse kemi vullnet të vogël kur bëhet fjalë për këtë krim. Në këtë drejtim ministri i ekologjisë në Britaninë e Madhe, Majk Miler thotë: Kriminaliteti ekologjik është një biznes i madh, i njëjtë sikurse organizatat kriminale që merren me drogë, më tregëtinë e armëve, trafikimin e qenieve njerëzore, për arsye se fitimi është shumë i madh.⁴ Mirëpo ia vlenë të përmendet se tregëtia me specien në zhdukje është shumë profitabile. Tregëtia e kafshëve të egra, të gjalla apo të vdekura, arrinë fitim deri në miliarda dollarë në vit. Tregëtia e kafshëve të egra përfshinë 2 deri në 5 milion shpendë të egra, 10 milion lëkura zvarranikësh, 7 deri në 8 milion kaktusa, mbi 500 milion peshk tropical etj. Tregëtia e paligjshme në kafshë të rralla, ose të mbrojtura arrinë në 6 miliardë në vit, kurse është fitimi më i madh se tregëtia e paligjshme në të gjithë botën në armë, raketa, dhe e dyta pas trafikimit të drogës.

Këto veprime çënojnë të drejtat themelore të njëriut të garantuara me ligj dhe konventa ndërkombëtare për një jetë më cilësore dhe më të mirë, kohën e fundit është duke u parë se si njeriu po kërcënohet nga sëmundje të llojeve të ndryshme, që vijnë si pasojë e përdorimit të lëndëve të ndryshme dhe helmin e tokës, ujit po ashtu dhe helmin e ajrit me anë të oxhaqeve të fabrikave të cilat funksionojnë pa kontrolle të posaçme shtetërore, tregëti dhe përpunim me lëndë të rrezikshme, si dhe shtimi i deponive të mbeturinave, mund të cekim numrin e madh të të vdekurve nga kanceri në mushkri viteve të fundit, vështirësim në frymëmarrje si dhe sëmundje të ndryshme të sistemit nervor dhe shumë probleme të cilat me hollësishtë do t'i cekim më poshtë.

Shumëllojshmëria e këtyre veprave që ndotin dhe rrezikojnë ambientin janë karakteristikë e këtij krimi dhe mungesa e vetëdijes në opinion, për rreziqet që mund të vijnë nga këto veprime e bëjnë që vullneti për kapjen e këtyre kryrësve të jetë i vogël si dhe vazhdimi dhe inspirimi i tjerëve për të kryer krime të vazhdojë.

Në kohën e fundit shtetet perendimore kanë ashpërsuar politikën në lidhje me krimet ekologjike dhe kanë ngritur vetëdijen tek shtetet e tyre, duke u vënduar kushte të rënda industrive të mëdha, mirëpo ato që më së shumti preken janë shtetet e varfëra dhe vendet në zhvillim për

⁴ BBC News online: World

shkak se nga leverdia, industrinë e mëdha i zhvendosin fabrikat e tyre në vendet ku nuk ka ligje të rënda ose nuk respektohen ato dhe atje më lehtë mund të veprojnë edhe me mbeturinat e rrezikshme dhe në këto vende nevoja për ngritjen e vetëdijes tek ato qytetarë është e domosdoshme, sepse po bëhet masakër me ambientin jetësor, kushtimisht me jetët e njerëzve duke u shkaktuar atyre vuajtje të rënda nga sëmundjet dhe helmimet të ndryshme që marrin në menyrë direkte dhe indirekte nga këto kompani të papërgjegjshme dhe shtete heshtë para tyre që me çdo kusht dhe çdo sakrificë mundohen të pasurohen, kurse në anën tjetër të shkatërojnë jetesën.

Në literaturën kriminologjike në kuadër të krimeve kundër ambientit ekzistojnë të dhëna statistikore vetëm të kohëve fundit, kurse viktimizimi nga ky kriminalitet po arrinë kulminacionin në aspektin e viktimave në qenie të gjalla. Në verën e vitit 2010, rusët pësuan valën më të keqe të nxehtësisë në 1,000 vjet histori të regjistruar ruse. Në Moskë, temperaturat tejkaluan 40 ° C për herë të parë në histori dhe shkalla e vdekshmërisë u dyfishua, nga goditjet e nxehtësisë dhe sëmundjet e mushkërive të shkaktuara nga tymi, nga djegia e pyjeve dhe kënetave. Nxehtësia dhe tymi u fajësuan për 11,000 vdekje në gusht. Më shumë se shtatë javë të temperaturave ekstreme shkatërruan gjithashtu një të tretën e të korrave të grurit rus dhe çmimet e grurit u dyfishuan në të gjithë botën. Temperaturat mesatare globale janë për rreth 1 ° C më e lartë se ata që kanë qenë në shekujt e kaluar.

1.2. Aspekti juridik i kriminalitetit ekologjik

Karakteri specifik i kriminalitetit ekologjik, rrezikshmëria e tij e madhe shoqërore si dhe rritja e përhershme e keqpërdorimit të mjedisit kërkojnë që këto probleme të rregullohen me dispozita të caktuara ligjore. Me vepra penale kundër mjedisit nënkuptohen ato vepra të kundërligjshme që çenojnë mbrojtjen e mjedisit nga ndotja, të kryera me faj dhe të parashikuara t nga legjislacioni penal.⁵ Sipas përkufizimit juridik, lëndë studimi të krimit ekologjik duhet të jenë të gjitha ato sjellje dhe veprime të cilat janë të inkriminuara dhe të parapara me norma pozitive juridike. Kështu që për të quajtur një krim ekologjik më së pari ajo duhet të jetë e paraparë me ligj ose akte tjera pozitive. Mirëpo përkufizimi juridik është shumë i ngushtë kur bëhet fjalë për këto krime të cilat shfaqen në mënyra të ndryshme në botën e jashtme, përkufizimi juridiko-

⁵ Zejneli Ismail, "E drejta penale-pjesa e posacme", Tetovë, 2007, fq. 105

formal ato i cakton në mënyrë statike sado që mundohen ligjvënësit ai nuk mund të përcaktoj realitetin i cili ndryshon për çdo ditë.

Shumica e shteteve në botë e posaçërisht ato evropiane i kanë inkriminuar në kodet e tyre penale të gjitha krimet në lidhje me ndotjen e ambientit, mirëpo të dhënat nga analizat e ndryshme tregojnë se kemi të bëjmë me një krimë kur numri i krimeve të pa paraqitura është shumë i madhë. Ndërsa vendet moderne me sisteme të qëndrueshme ekonomike kanë tendencë për të mbrojtur mjediset ekologjike, duke përdorur ligjin penal, në vendet më pak të zhvilluara dhe atyre në tranzicion, krimi është “de facto” një formë të legalizuar. Në shumicën e sistemeve ligjore të këtyre vendeve janë aktet penale dhe ligjin penal ekologjik, por asnjëri prej tyre nuk janë zbatuar nga organet kompetente. (Selinšek, 2006).⁶

Këto krime në vendin tonë janë të sanksionuara me kushtetutë, me ligje si dhe me konventa ndërkombëtare të nënshkruara nga Republika e Maqedonisë.

1.2.1. Konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare lidhur me krimin ekologjik

Sipas informatave zyrtare në dispozicion në faqen e internetit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Maqedonia ka qenë pjesë e 41 traktateve shumëpalëshe ndërkombëtare në lidhje me aspekte të ndryshme të mjedisit. Këtu do të përmendim disa:

Konventat ndërkombëtare, deklaratat, protokollat:

- Konventa mbi ligatinat me rëndësi ndërkombëtare për mbrojtjen e zogjve ujorë (Ramsar).
- Konventa e ndikimeve ndërkufitare mjedisore (Konventa Espoo)
- Protokoli mbi vlerësimin strategjik të ndikimit në mjedis.
- Konventa mbi Diversitetin Biologjik (Konventa Rio, 1992)
- Protokoli mbi biosigurinë (Cartagena Protocol)
- Konventa mbi Qasjen në Informata, Pjesëmarrjen Publike në Vendimmarrje dhe Qasje në Drejtësi në çështjet që lidhen me mjedisin (Konventa ARHUNSKA)
- Protokoli Regjistri i ndotjeve dhe transferimit të ndotësve (PRTRs Protocol)

⁶Crimes against the Environment: Green Criminology and Research Challenges in Slovenia 2011 fq.9

- Protokoli mbi Ndotësit Organik të Qëndrueshëm (NOQ Protocol)
- Protokoli mbi Metalet e Rënda
- Konventa për Ruajtjen e llojeve migratore të kafshëve të egra (Konventa e Bonit)
- Konventa për Ruajtjen e Jetës së Egër dhe Habitave Natyrore Evropiane (Konventa e Bernës)
- Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Botërore Kulturore dhe Natyrore
- Konventa për mbrojtjen e ozonit Cover (Konventa e Vjenës)
- Protokoli i Montrealit dhe ndryshimet e Protokollit
- Konventa për kontrollin ndërkufitar të mbeturinave të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre (Konventa BAZALSKA)
- Konventa Kornizë e Ndryshimeve Klimatike të Kombeve të Bashkuara
- Protokoli i Kiotos
- Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës
- Konventa për ndotjen e ajrit në distancë të largët Ndërkufitar (Konventa e Gjenevës)
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për luftën kundër shkretëtirizimit në vendet Përjeton Serious Thatësira dhe / ose Shkretëtirizimit, veçanërisht në Afrikë
- Konventa mbi të para informoi tregtisë ndërkombëtare në kimikateve dhe pesticideve (Konventa Rotterdam) rrezikshme
- Konventa mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm (Konventa e Stokholmit)
- Konventa mbi njoftimin e hershme e një aksidenti bërthamor

Aktet ndërkombëtare parashikojnë përgjegjësi individuale si dhe kolektive për mosrespektim të të drejtave dhe detyrimeve të subjekteve dhe atë, si në nivel ndërkombëtar, poashtu edhe në nivel nacional. Me akte ndërkombëtare kufizohen aktivitetet e paligjshme të shteteve nëse dëmtojnë shtetin tjetër, si dhe të dëmtojë interesat e ligjshme të shteteve të tjera. Përkundrazi, sipas rregullave të së drejtës ndërkombëtare të përgjithshme, shtetet janë të detyruara të pengojnë dëmtimin e mjedisit të shteteve të tjera me ndotës të ajrit, të ujit, të tokës dhe nëse kjo ndodh, të paguajnë dëmshpërblimin. E drejta ndërkombëtare për dëmet që i shkaktohen mjedisit jetësor, parashikon shumë rregulla lidhur me përgjegjësinë e shteteve. Me vendim përcaktohet se shteti përgjigjet për veprimet e organeve të veta, po edhe të personave privat nën juridiksionin e tij, se çështja e ndotjes s'mund të zgjidhet vetëm me pagimin e dëmit, por është e domosdoshme të arrihet marrëveshja në kontrollin e aktiviteteve që mund t'i

shkaktojnë dëme mjedisit, në mënyrë që kjo të pengohet ose të zvogëlohet sa më shumë që është e mundur. Republika e Maqedonisë e ka harmonizuar legjislacionin e vetë me konventat ndërkombëtare.

1.2.2 Kushtetuta dhe ligjet vendore për mbrojtjen e ambientit jetësor

Ministria e ambientit jetësor dhe planifikimit hapsinor është institucion zyrtar dhe kyçës në Republikën e Maqedonisë për zhvillimin dhe miratimin e projekteve dhe ligjeve në lidhje me mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Ajo është e ndarë në disa sektorë:

- Sektori për çështje evropiane, sektori për zhvillim të qëndrueshëm,
- Departamentit të Planifikimit Hapsinor,
- Departamenti i legjislacionit dhe i standardizimit,
- Qendra Informative për Mjedisin,
- Sektori i administrimit Mjedisor
- Sektori i GIS,
- Inspektorati shtetëror për mjedisin jetësor,
- Drejtoria për marrëdhënie me publikun

Administrata mjedisit kryen veprimtari profesionale dhe mbikëqyrjen teknike mbi zonat e mbrojtura të natyrës, burimet e ndotjes së tokës, ujit dhe ajrit, propozime për zgjidhje profesionale, teknike dhe teknologjike për zvogëlimin ose parandalimin e ndotjes dhe shkatërrimin e mjedisit, duke studiuar dokumentacionin teknik mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës dhe përmirësimin, masat zbatuese dhe monitorimin e ndryshimeve të mjedisit, dmth ndryshimet në natyrë.⁷ Ligji për mjedisin ka për qëllim mbrojtjen dhe përmisimin e cilësisë dhe gjendjes së mjedisit, tokës, ujit, ajrit, biodiversitetin dhe burimet e tjera natyrore, si dhe mbrojtjen e shtresës së ozonit dhe parandalimin e ndikimeve negative të njeriut në sistemin e klimës.

⁷ Environmental and Social Assessment Management Framework - ESAMF) Shkup 2014 fq.6

Objektivat e ligjit janë:

- ✓ Identifikimi dhe monitorimi i gjendjes së natyrës;
- ✓ Ruajtja dhe restaurimi i shumëllojshmërisë ekzistuese biologjike dhe pejsazhore në një gjendje të baraspeshës natyrore;
- ✓ Krijimi i një rrjeti të zonave të mbrojtura për mbrojtje të përhershme të pronave mbi të cilat fituar statusin e trashëgimisë natyrore;
- ✓ Duke siguruar përdorimin e qëndrueshëm të pasurisë natyrore në dobi të zhvillimit të tanishëm dhe të ardhshëm, pa dëme të konsiderueshme në disa pjesë të natyrës dhe me shqetësim të vogël të mundshëm të baraspeshës natyrore;
- ✓ Parandalimi i aktiviteteve të dëmshme të personave fizik dhe juridik dhe çrregullimeve në natyrë, si rezultat i zhvillimit teknologjik dhe realizimin e aktiviteteve, përkatësisht ofrimin e kushteve më të mira për mbrojtjen dhe zhvillimin e natyrës dhe
- ✓ Duke siguruar të drejtën për një mjedis të shëndetshëm.⁸

Mbrojtja e mjedisit jetësor është e rregulluar me shumë akte edhe at me :Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë,Ligji për kundërvajtje për mbrojtjen dhe përmisimin e mjedisit jetësor.Dokumentit më të rëndësishëm të cilin duhet gjithkush që merret me mbrojtjen e mjedisit ta dijë është Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e cila i vë themelet e të gjithë akteve që duhet të merren të jenë në harmoni më të, e cila në nenin 43 definon të drejtën e çdo qytetari për mjedis jetësorë të shëndoshë ku thuhet:”Secili njeri është i detyruar të mbrojë dhe përmirësoj mjedisin jetësor dhe natyrën.Republika e Maqedonisë duhet të siguroj kushte për realizimin e të drejtës të çdo qytetari për mjedis të shëndoshë.Secili njeri ka të drejtë për mjedis të shëndoshë.”

Kurse dokumenti tjetër ligjor themelor për punën e organeve kompetente për ndjekjen dhe dënimin e këtij krimi është Kodi penal i cili me një numër të madh veprash e përfshinë këtë

⁸<http://www.akademik.mk/pregled-na-domashnoto-zakonodavstvo-so-koe-se-shtiti-i-unapreduva-zhivotnata-sredina/>

lloj të kriminalitetit. Ku në nenin 218 të kodit penal thuhet: "Ai i cili me mos respektimin e dispozitave ligjore për mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor do të ndotë ajrin, ujin, tokën sipërfaqen ujore dhe rrjedhën e ujit në vëllim më të madh ose në territor më të gjërë dhe me të do të shkaktoj rrezik për jetën apo shëndetin e njerëzve apo zhdukjen e botës shtazore apo bimore në përmasa më të mëdha, do të dënohet me burgim prej 4 deri 10 vjet." Në kodin penal janë paraparë disa lloje të veprave penale kundër mjedisit jetësor si përshembull: Ndotja e ujit të pijshëm, prodhim i mjeteve të dëmshme për mjekimin e shtazëve dhe gjallesave, dhënia e pandërgjegjshme e ndihmës veterinare, bartja e sëmundjeve ngjitëse në botën shtazore dhe bimore, ndotja e ushqimit ose ujit për kafshët, shkatrimi i pyllit, gjuetija e paligjshme etj. Në kodin penal në mënyrë specifike janë përmendur llojet e krimit kundër ambientit dhe për ta është caktuar dënim, që të lehtësojnë punën e policisë dhe organeve tjera kompetente për ndjekje dhe ekzekutim.

Dokumenti tjetër ligjor është Ligji për kundërvajtje i cili po ashtu përfshinë një lloj të veprave të kundërligjshme, mirëpo me rrezik me të vogël si dhe me dënim në të holla, ai në nenin 39 në ligjin për kundërvajtje për shkatrimin e rendit dhe qetësisë publike merret me ndotjen e mjedisit jetësor.⁹

Në vitin 2008 ka hyrë në fuqi edhe Ligji për pastërti publike i cili i obligon komunat dhe personat juridik dhe fizik për mirëmbajtjen e ambientit ku dhe janë paraparë edhe gjoba prej 50 deri 4000 euro.

Ligji për mjedisin jetësor dhe ligji për cilësinë e ajrit janë gjithashtu në fuqi dhe me qëllim evitimi, parandalimi dhe zvogëlimin e efekteve të dëmshme ndaj shëndetit të njeriut dhe ambientit jetësor si tërësi, duke i përfshirë edhe llojllojshmërinë biologjike, pasurinë natyrore dhe trashëgiminë historike e kulturore, sigurimi i informatave përkatëse për kualitetin e ajrit të ambientit, parandalimi dhe zvogëlimi i ndotjeve që shkaktojnë ndryshimin e klimës, dhe mirëmbajtja e kualitetit të ajrit të ambientit aty ku është i mirë dhe përmirësimi në raste të tjera si dhe ruajtja, mbrojtja, përparimi i cilësisë së mjedisit jetësor.

Republika e Maqedonisë në mënyrë ligjore mbron të gjithë ambientin jetësor si dhe bimët dhe gjallesat tjera me anë të ligjeve të ndryshme të inkriminuara si përshembull ligji për ujrën, ligji për mbeturinat të gjitha këto në harmoni me nenin 43 të kushtetutës si dhe me direktivat dhe

⁹Vancoska Nikolina, "Kriminaliteti ekologjik-ligjislacioni dhe pjesët e punës së policisë", fq.326-327, Shkup

konventat internacionale që formalisht ju siguron qytetarëve të drejtat elementare për jetesë. Për ligjet vendore dhe konvetat mundet të flitet shumë në menyrë ta detajuar, mirëpo ne do të fokusohemi në aspektin kriminologjik të këtyre veprave por ishte e drejtë që të përmendim disa prej tyre që të na ndihmoj për zbërthimin e lëndës.

KAPITULLI I DYTË

FENOMENI I KRIMIT EKOLOGJIK NË RAJONIN E POLLOGUT

2.1 Vëllimi dhe struktura e kriminalitetit ekologjik në rajonin e Pollogut

Si ndotës kryesorë të Rajonit Pollogut cilësohen:

- Jugohrom Ferroalloys (Pas mbylljes më 1 Nëntor 2016 ndotja ka rënë deri në 60%)
- Automjetet pa standarde ekologjike (Tetova numëron rreth 42000 automjete të regjistruara me targat TE)
- Amviseritë, pjesa dërmuese e të cilave ngrohen me dru ose lënde tjera djegëse (Sidomos gjatë sezonit të ngrohjes).
- Industritë tjera më të vogla, fabrikat për prodhimin e mobiljeve, automekanikët që djegin vajra të ndryshëm, goma, etj.
- Mungesa e hapësirave të gjelberta është poashtu problematikë.
- Urbanizimi pa kriter, ndërtimet e larta të cilat bllokojnë qarkullimin e ajrit,
- Deponitë e egra në të cilat shpeshherë digjen mbeturinat nga më të ndryshmet.

Problemet mjedisore në vend janë të ngjashme me ato të vendeve të tjera të rajonit. Problemet e shumta dhe mangësitë e identifikuara nëpërmjet projekteve të ndryshme, studimet dhe dokumentet e planifikimit janë të dukshme në media dhe zonat mjedisore të tilla si:

- Mungesa e sistemeve të integruara rajonale për sistemet komunale për menaxhimin e mbeturinave të ngurta, me lloje të veçanta të mbeturinave përfshirë mbetje të rrezikshme.
- Mbulimi i pamjaftueshëm i vendbanimeve dhe komunave me sisteme të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të zeza (sidomos për aglomeratet me më shumë se 10.000 banorë).
- Nevoja për të krijuar menaxhimin e integruar të basenit lumor në përputhje me Ligjin e ri për ujëra.

- Kontaminimi i tokës që rezulton në prodhimin e produkteve bujqësore me cilësi të pamjaftueshëm të zonave me tokat e kontaminuara.
- Ka një problem në sigurimin e menaxhimit të duhur të trashëgimisë natyrore. Me përjashtim të parqeve kombëtare Pelister, Mavrovë dhe Galiçica, dhe disa monumente të natyrës, objekte të tjera të natyrës ende nuk janë emëruar në menaxhimin e njësive ekonomike
- Ndotja e ajrit e intensitetit të ndryshëm në pjesë të ndryshme të vendit.¹⁰

Për ta kuptuar më së miri këtë dukuri këtu do të na duhet ndihma e fenomenologjisë kriminale, e cila është pjesë e kriminologjisë dhe merret me studimin e formave të paraqitjes së kriminalitetit me strukturën dhe dinamikën e tij.¹¹

Kjo merret me studimin e formave të veprave të kryera penale dhe me vetit shoqërore të kryerësve të këtyre veprave. Kjo degë gjithashtu merret edhe me studimin e shtrirjes së tyre në aspekt kohorë dhe territorial si dhe me përmasat apo vëllimin e tyre. Këtu gjithashtu do t'i ndajmë këto krime në bazë të karakteristikave regjionale ,sezonale dhe periodike por gjithashtu në bazë të gjinisë dhe moshës së kryerësve.

Kriminaliteti në thelb është një dukuri negative shoqërore e ndërlikuar për tu shpjeguar dhe për tu hulumtuar sepse ajo ndikohet nga shumë faktorë të ndryshëm që kanë të bëjnë me zhvillimet e brendëshme si dhe të jashtme të individit. Kur të gjithë këto faktorë ndikojnë në manifestimin e veprimit në botën e jashtme paraqitet edhe më shumë nevoja për mbrojtje nga kjo dukuri negative. Por për mbrojtje dhe parandalim nga kjo dukuri duhet më së pari të studiohen shkaqet dhe format e paraqitjes së tij në shoqëri dhe këtë më së miri e bëjnë shkenca e kriminologjisë, por nuk duhet mohuar edhe ndihmesën e madhe që japin edhe shkencat tjera si kriminalistika, mjeksia ligjore etj.

Aspekti kriminologjen është shumë i rëndësishëm për shkak se viktimat e krimit kundër ambientit janë të shumtë në numër dhe mund të prekin cilindo pa marrë parasysh dhe vazhdojnë me gjenerata të tëra, gjë që mund të vijë në pyetje edhe ekzistenca njerëzore.

Shumica e hulumtuesve për krimin kundër ambientit mendojnë se është e nevojshme krijimi i shumë organizatave dhe institucioneve për ndjekjen e këtij krimi, mirëpo shumë më e nevojshme është promovimi i ngritjes së vetëdijes njerëzore në lidhje me shkaqet dhe pasojat e

¹⁰ Enti shtetëror për statistika i Republikës së Maqedonisë

¹¹ Halili Ragip, "KRIMINOLOGJIA" Prishtinë, 2011, fq. 115

këtij krimi që më mirë të parandalohet, sepse dëmët që vijnë nga ky lloj i krimit janë të mëdha për nga vëllimi dhe gati të pa përmirësueshme ose duhet mijëra vjet dhe harxhim të mjeteve të konsiderueshme materiale për kompensimin e tyre. Shoqëria bashkëkohore sot po përjeton humbje të mëdha ekonomike, kriza të ndryshme botërore politike dhe shoqërore. Kjo tregon se shtetet kanë probleme të brendëshme në lidhje me funksionimin normal të institucioneve dhe mbrojtjen e qytetarëve dhe kjo për arsye të zhvillimit të hovshëm ekonomik dhe teknologjik që sjell deri te kërcënimi i ambientit jetësor.¹²


Në Republikën e Maqedonis gjegjësisht rajonin e Pollogut kesi lloj krimesh kemi në numër të shumtë kurse gjendja është alarmante sepse Tetova është ranguar në listën e vendeve me ajër më të ndotur në botë sipas organizatave botërore, aty ku qytetarëve u merret e drejta elementare për ajër të pastër, kurse po ashtu menaxhimi me mbeturina nga ana e ndërmarrjeve komunale bëhet në mënyrë jo profesionale duke helmuar ajrin me djegjen e tyre në deponin e pozicionuar në hyrje të qytetit ku jetojnë dhe kalojnë një numër i madh njëhënjësh që çdo ditë thithin ajrin e ndotur, kur përmendet ajri i ndotur është e pakuptimtë në rajonin e Pollogut nëse nuk përmendet Kombinati “Jugohrom Ferroalloys” i cili pozicionohet në verilindje të Pollogut më saktësisht në Komunën e Jugonovcës, ku si e vetmja fabrikë industriale me prodhim më të madh në vend, ka të punësuar një numër të madh punëtorësh të cilët kryesisht vijnë nga familje me ekonomi të dobët me anë të së cilës sigurojnë jetesën, ajo punon jashtë çdo standardi ekologjik të paraparë me ligj dhe në mënyrë të papërgjegjshme helmon rajonin me lirimin nga oxhaqet e tij gazra helmues, nga djegja e materieve punuese, është e rëndësishme këtu të përmendim si specifike në mënyrë të veçantë se për ajrin e ndotur kontribuon numri i madh i oxhaqeve të amvisërive kështu që në këtë rajon djegja dhe ngrohja me drunjë është më se e zakonshme dhe normale ku kësaj dukurie i paraprijnë disa faktorë ekonomiko-politik si dhe këtë dukuri e paraprijnë edhe fenomeni i prerjes së paligjështme të pyjeve për të cilat do të zgjerohemi më poshtë, në qytetet dhe fshatrat e këtij rajoni kemi mungesë të kanalizimeve, edhe ato kanalizime që janë bërë shumica me vet iniciativën e qytetarëve kurse shteti dhe komunat kanë lënë pas dore një nevojë të cilën shtetet e perëndimit e kanë përfunduar që në mesjetë, kurse tek ne mbetet një ëndërr. Lidhja e këtyre dukurive negative me shëndetin dhe mirëqenien e njeriut është shumë e dukshme.

¹² Sazdovska Marina, “kriminalisticka policia i ekoloshkiot kriminalitet”, Shkup, 2005, fq.56

Sipas të dhënave të entit për statistika të RM gjatë periudhës 2011-2015 janë paraqitur një numër i konsiderueshëm i veprave penale kundër mjedisit jetësor dhe natyrës, të dhënat vijnë kështu:

Grafikoni nr.1¹³

Numri i veprave penale të paraqitura kundër mjedisit jetësor dhe natyrës në Republikën e Maqedonisë për periudhën 2011-2015.




Gjatë vitit 2011 janë paraqitur 174 raste të kallëzimeve penale, kurse gjatë vitit 2012 shohim një rritje të numrit të kallëzimeve penale të paraqitura 253, kurse gjatë viteve të ardhëshme ka një rënie të paraqitjeve të kallëzimeve penale.

¹³ Enti shtetëror për statistika i Republikës së Maqedonisë

Grafikoni nr.2¹⁴

Llojet e veprave penale kundër mjedisit jetësor dhe natyrës në Republikën e Maqedonisë
të paraqitura periudhën 2011-2014




Gjatë vitit 2015 shohin një interesim më të madh nga ana e organeve kompetente për këtë lloj kriminaliteti për shkak se kemi një numër më të madh veprash të llojeve të tjera të cilat këtyre viteve që përmendëm me lartë nuk hasim ndonjë paraqitje të veprave tjera nga kodi penal në lidhje me veprat penale kundër mjedisit dhe natyrës ato lloj veprash do t'i shofim në diagramin më poshtë.

¹⁴ Enti shtetëror për statistika i Republikës së Maqedonisë

Grafikoni nr.3¹⁵

Llojet e veprave penale kundër mjedisit jetësor dhe natyrës në Republikën e Maqedonisë të paraqitura në vitin 2015.



¹⁵ Enti shtetëror për statistika i Republikës së Maqedonisë

Mund të themi se vitin e fundit kemi një ngritje të vetëdijes për këto lloje krimesh sepse në vitet kaluara ka pasur një numër të madh vetëm të gjuetisë së paligjshme kurse tani këto lloj krimesh po ngjallin një interesim më të madh tek qytetarët dhe organet kompetente. Mirëpo përsëri mund të themi se në krahasim me veprat tjera penale numri i paraqitjeve të këtyre krimeve është shumë më i vogël se realiteti, domethënë këtu kemi një paraqitje të fenomenit “numri i errët” ku shumë vepra të paligjshme nuk paraqiten apo edhe mbulohen nga vetë qytetarët apo organet e ndjekjes.

Duke pasur parasysh se si ki kriminalitet kryhet në shumtën e rasteve nga ana e kompanive të mëdha atëherë lirisht mund të themi se kemi të bëjmë me kriminalitet të oranzuar apo të “Jakës së bardhë”, këtë termë së pari e ka përdorur sociologu amerikan Edvin Sutherland, sipas tij fjala është për individ dhe grupe që kanë pozita dhe ndikim të fuqishëm në rrjedhat ekonomike, politike dhe shtetërore në vend, ato i shfrytëzojnë këto lidhje për qëllime kriminale. Ato që i mbrojnë këto individ dhe grupe kriminale shpesh herë i furnizojnë me të dhëna të ndryshme në lidhje me aktivitetin kriminal. Individët e tillë delikuentët i mbrojnë nga zbulimi dhe ndjekja e policisë, i lirojnë nga aktakuzat, i shpëtojnë nga gjykimi ose i ndihmojnë që të dalin para kohe nga vuajtja e dënimit.¹⁶

Gjithashtu këtu mund të hasim edhe të ashtuquajturin “Kriminalitet profesional”. Ky kriminalitet quhet profesional për arsye se me atë merren në mënyrë të rregullt dhe ky aktivitet i tyre është bërë profesion dhe mjeshtri e përhershme e tyre. Nga kjo veprimtari kriminale, personat e tillë realizojnë të ardhura dhe fitime të mëdha.¹⁷

2.2 Disa veçori themelore të kriminalitetit ekologjik në rajonin e Pollogut

Veprimet kriminale si sjellje të jashtëligjshme janë dinamike sepse ato përsosen gjatë kryerjes së krimit, kurse është e vështirë që ta shpjegosh me një fjalë të vetme, sepse kriminaliteti si dukuri negative shumë e pranishme zhvillohet gradualisht dhe ndryshon. Karakteristikat kryesore të kriminalitetit kundër mjedisit dhe natyrës nga pikpamja kriminalistike janë: anonimiteti i viktimës për shkak se viktimat e krimit nuk mund të gjendet çdoherë në vendin e ngjarjes, kurse

¹⁶ E. Sutherland, “Krimi i jakës së bardhë”, 1949, fq. 38-47

¹⁷ Halili Ragip, “Kriminologjia”, Prishtinë, 2011, fq. 135

kryerësi i veprës është shumë i vështirë për tu indentifikuar. Në lidhje me këtë kriminalitet nga shoqëritë e më herëshme nuk kemi të dhëna në lidhje me veçoritë e tyre sepse ky kriminalitet si dukuri negative ka filluar të studiohet vonë dhe të dhënat mbi kryerësit e tyre janë përgjithësisht nga koha moderne. Mirëpo nëse shikojmë nga aspekti territorial këto krime dhe kriminelët dallojnë nga vendi në vend, ashtu që në vendet e zhvilluara është arritur një vetëdije më e madhe lidhur me këto krime ku gati gjithëkush mundohet të rruaj ambientin jetësor, kurse në vendet në zhvillim apo ato të pazhvilluara njerëzit si prioritet i vënë kushtet ekonomike përpara atyre mjedisore.

Vecoritë e krimit ekologjik

Emanov ka përcaktuar disa vecori të krimit ekologjik të cilat do t'i paraqesim më poshtë:

- Krimi ekologjik është një fenomen i komplikuar, prandaj hetimi është i gjatë dhe mjaftë kompleks,
- Krimi ekologjik shpesh ndryshon nga një vend në tjetrin në nivel global, kombëtar dhe rajonal,
- Eko-krimi është i vështirë të vërehet, dhe po ashtu është i vështirë për të zbuluar,
- Dënimet ndaj krimit ekologjik nga njerëzit përceptohen si mjaft apstrakte,
- Veprat penale të krimit ekologjik karakterizohen nga matshmëria e dobët nga aparati shoqërorë, e më këtë e bënë të vështirë si zbulim ndërsa ndëshkimin ende më të vështirë,
- Në rast të dënimit të shkelësve duhet të merren parasysh edhe standartet e huaja ligjore, sidomos legjislacioni i BE- së për mbrojtjen e mjedisit,

Duhet të kemi të qartë se krimi ekologjik ose mjedisor ka dy viktima dhe atë: mjedisin dhe njeriun. Mjedisi është viktima e drejtpërdrejt ose primare, ndërsa njeriu është viktima sekondare.¹⁸ Mirëpo duke e shikuar historikisht problemet me mjedisin sa vijnë dhe shtohen dhe po ashtu komplikohen kurse kryerës gjithmon paraqitet njeriu dhe shoqatat apo korporatat e mëdhatë krijuara nga ai dhe si motiv kryesor mund të themi se dominon motivi financiar. Dhe nga vendi në vend dhe nga koha në kohë këto krime kanë strukturë të veçantë dhe karakteristika të veçanta që e dallojnë atë prej tjetrit. Këto karakteristika janë të lidhura ngushtë me kushtet ekonomike, shoqërore, politike të një vendi dhe ato ndikojnë në masë të madhe tek kryerësit

¹⁸ Eman, K, 'Ekoloska kriminaliteta v kriminologiji; RAZVOJ NOVE VEJE KRIMINOLOGIJE V Slovenija. Resvija za kriminalistiko in kriminologijo" 2011, faq.312-324

.Kryerësit e veprave penale kundër mjedisit jetësorë dhe natyrës në Republikën e Maqedonisë janë shumica persona madhorë.Dhe duke pasur parasysh multietnicitetin e RM duhet konstatojmë se shumica e kryerësve të veprave penale kundër mjedisit janë të komunitetit Maqedonas me 550 apo 68 % e kryerësve të përgjithshëm brenda viteve 2010-2015, kurse shqipëtarë 133 apo 17 %, turq 30 apo 4 % si dhe komunitetet tjera me 11%.

Tabela nr.1¹⁹

Kryerësit e veprave penale kundër mjedisit jetësorë dhe natyrës në RM në bazë të nacionalitetit

Nacionaliteti	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Gjithësej
Maqedonas	58	116	129	92	89	66	550
Shqipëtar	19	18	19	22	14	41	133
Turq	2	4	10	13	-	1	30
Të tjerë	3	8	21	21	15	24	92

2.2.1 Zhvillimi industrial dhe kriminaliteti ekologjik

Revolucioni industrial është emri që historianët dhe ekonomistët i vendosin një periudhe historike të ekzistencës njerëzore, që u karakterizua nga ndryshime të shpejta dhe të mëdha në mënyrën e bërjes së gjërave.Ndryshimi thelbësor kishte të bënte me tranzicionin nga punishte të vogla në fabrika më të mëdha ku punonin një numër më i madh njerësisht, ku krijohesh një numër më i madh produktesh dhe që shitej me një çmim më të vogël.Qëllimi kryesor i revolucionit industrial ishte në rritjen e standardeve të jetesës së njerëzve.²⁰

¹⁹ Enti shtetëror për statistika i Republikës së Maqedonisë

²⁰https://sq.wikipedia.org/wiki/Revolucioni_industrial

Mirëpo sa më shumë që rritej prodhimtaria aq më shumë përdoreshin resurset natyrore dhe normal që filloi brengosja për harxhimin dhe keqpërdorimin e tyre, kurse gjatë përpunimit të tyre nëpër fabrika krijoheshin mbetje të rrezikshme që hüdeshin në tokë dhe ajër për arsye se reciklimi i tyre ishte i kushtueshëm për industrinë. Pas Luftës së Dytë Botërore pati një rritje aq të shpejtë të popullsisë, që solli më shumë nevoja për ushqim dhe kërkesa të shumëfishuara për më shumë prodhimtari bujqësore. Për të plotësuar këto nevoja, praktikat bujqësore ndryshuan, me synim rritjen e prodhimtarisë. U përdorën për herë të parë plehrat kimike dhe pesticidet, si edhe u shfrytëzuan masivisht burimet ujore, u dogjën lëndët djegëse natyrore pa kriter e pa kursim. Toka filloi të shfrytëzohej dhe jo të përdorej. Sot, globi përballlet me pasojat e këtyre veprimtarive që kanë shfrytëzuar resurset në maksimum. Pasojat janë shumë serioze; ndryshime klimatike, ndotje dhe thatësira masive në anë të ndryshme të rruzullit. Praktikatat e përdorura deri më tani në bujqësi janë shndërruar në problematikat më të mëdha.²¹

Një nga faktorët më të rëndësishëm që ndikon në rritjen e problemeve të mjedisit është edhe shtimi i popullsisë. Sipas të dhënave të sotme popullsia e botës është 7 miliardë. Për të përballuar nevojat e kësaj popullsie duhet të rritet edhe industrializimi. Ndërsa rritja në industrializim shkakton shterimin me shpejtësi të burimeve natyrore. Ndërkaq mbetet që burojnë nga prodhimi dhe konsumi ndikojnë negativisht mjedisin. Studimet e bëra tregojnë se 50% e ndotjes aktuale në botë ka ndodhur gjatë 35 viteve të fundit. Sipas raportit të Fondacionit për Mbrojtjen e Botës në vitin 2030 burimet ekzistuese do të jenë të pamjaftueshme për popullsinë e botës.²²

Një brengosje shumë e madhe për ndotje vjen nga rafineritë e naftës. Sipas Këshillit të Burimeve Natyrore Mbrojtëse (2001), industria e rafinimit të naftës është një nga burimet kryesore të ndotjes në Shtetet e Bashkuara. Industria e rafinimit të naftës është burimi më i madh industrial i komponimeve organike të paqëndrueshme; burimi i dytë më i madh industrial i dioksidit të squfurit; dhe i treti burimi më i madh industrial i oksideve të azotit, oksid karboni, hidrogjeni, dioksidi i squfurit. Emetimet në ajër janë rezultat i keqfunksionimit të pajisjeve, proceset e djegies, dhe gabimeve të transportit. Ku arrihet edhe tek infektimi ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore.

²¹<http://agroweb.org/?id=10&l=358&ln=sq>

²²<http://www.trt.net.tr/shqip/ndergjegjesimi-mjedisor/2016/06/13/rritja-e-popullsise-dhe-ndotja-e-mjedisit-213357>

Ndotja e tokës në përgjithësi është rezultat i derdhjeve të naftës dhe përdorimit të deponive. Ajri, uji, dhe ndotësit e tokës të gjeneruara nga industria e rafinimit të naftës janë të lidhura direkt me një gamë të gjerë të shëndetit të njeriut dhe të problemet e mjedisit. Shumë nga këto janë të njohura si arsye që shkaktojnë kancerin dhe janë gjithashtu përgjegjës për dëmtim të mëlçisë dhe dëmtime kardiovaskulare.

Pasojat e shëndetit të njeriut nga ekspozimi ndaj ndotësve të ajrit janë: dëmtimi i veshkave, çrregullimet e gjakut, toksiciteti riprodhues dhe zhvillimor, çrregullime të mushkërive, dhe anemi (EPA, 1995b). Përveç kësaj për të shkaktoar një bollëk të problemeve shëndetësore të njeriut, ekspozimi ndaj ndotësve të krijuara nga rafineritë e naftës shkakton një shqetësim dhe frikë në mesin e banorëve që jetojnë pranë vendeve të rafinimit të naftës.²³

Viteve të fundit sa vjen e më shpesh e dëgjojmë termin zhvillim i qëndrueshëm dhe mjedis jetësor por çfarë në realitet nënkupton kjo? Kjo mund të përkufizohet si një formë e zhvillimit jo vetëm ekonomik, por edhe social, në të cilin rritja ekonomike do të mbahet brenda kufijve të ekosistemit. Pasojnë mundësitë ekologjike dhe aftësia e tyre për të përmbushur nevojat e brezave të ardhshëm. Është një proces në të cilin fusha të ndryshme të politikave të tilla si ato ekonomike, të tregëtisë, energjisë, bujqësisë, industrisë etj janë bërë në mënyrë që të krijohet një zhvillim që është ekonomikisht, shoqërisht dhe ekologjikisht i aftë për një zhvillim të qëndrueshëm.²⁴

Industrializimi bën pjesë tek faktorët ekonomik dhe si i tillë ka ndikim të madh në drejtimin e zhvillimit të shoqërive bashkohore. Kur flitet për industrializimin si faktor kriminologjen, zakonisht mendohet në disa pasoja të cilat paraqiten gjatë këtij procesi, në vende të ndryshme. Procesi i hovshëm i industrializimit dhe urbanizimi i qendrave të ndryshme në shoqëritë bashkohore ka sjellë me vete lëvizjen, migrimin dhe grumbullimin e madh të popullsisë nëpër disa qendra dhe qytete. Kështu janë krijuar qendra të mëdha industriale me miliona banorë.²⁵

²³ Melissa-L. Jarrell, "Environmental Crime and the Media" NY, 2007, fq.44

²⁴ Dr. Zef Mulaj "http://www.shekulli.com.al/p.php?id=224872"

²⁵ Halili Ragip, "KRIMINOLOGJIA", Prishtinë, 2011, fq.243

Në të shumtën e rasteve ky migrim është bërë jashtë normave ku në një vend me territor të vogël janë grumbulluar një numër i madh banorësh, dhe për shkak të nevojave të tyre, përdorimi i makinave me lëndë djegëse dhe numri i madh i fabrikave industriale çon deri tek koncentrimi i dioksidit të karbonit në atë vend apo qytet të jetë më i madh sesa nëpër vende rurale. Për shkak të numrit të madh të banorëve dhe subkulturave të ndryshme, ato nuk mund të punësohen dhe të krijojnë kushtet për të cilat ato kanë migruar dhe nga dëshira për të arritur diçka njerëzit mundohen me çdo kusht që të kenë sukses pa marrë parasysh se a dëmtohet natyra apo jo, kur është në pyetje mirëqenia e tyre.

Zhvillimi industrial solli një numër të madh të motorëve me degje të brendëshme si aeroplanët dhe automobilat, sot në botë ka mbi 400 milion automobil të cilët shpenzojnë më shumë oksigjen sesa njerëzit. Ka shumë burime që ndotin ajrit atmosferik, si më të rëndësishme të cilat mund të jenë të theksuara janë: industria për prodhimin e energjisë termike dhe elektrike, metalurgjia, industria kimike, industria e ndërtimit, minierave, industria ushqimore, transporti bujqësia dhe ekonomia.

Në industrinë e prodhimit të energjisë termike bëjnë pjesë ngrohja nëpër objektet industriale, ngrohja nëpër objekte privat, e shtëpi institucione e tjerë, një numër i madh në rajonin e Pollogut ngrohen me lëndë të drurit dhe qymyrit kurse me gaz natyrorë dhe energji elektrike shumë më pak për arsye të kushteve ekonomike, një familje normale në rajonin e Pollogut nuk mund të përballon ngrohje me energji elektrike sepse është e kushtueshme, kurse sistemi i gazit natyror nuk është i pranishëm në këtë rajon ndoshta edhe për arsye politike.

Në sferën e metalurgjisë në rajonin e Pollogut funksionon fabrika më e madhe në vend “Jugohrom Ferroalloys” i cili ka punuar krejt jashtë standarteve por e mbrojtur nga ana e pushtetit. Materialet metalurgjike që ndotin atmosferën e ajrit mund të jenë natyra fizike dhe kimike. Në shumicën e substancave të dëmshme janë të përhapura komponimet e sulfurit, monoksidit të karbonit dhe dioksidi të karbonit. Kurse për shkak të pozitës geografike të rajonit i cili shtrihet në fushëgropë dhe errërat gjatë disa sezoneve nuk janë prezente ajri i ndotur nga fabrikat, automjetet si dhe ngrohja me drunjë, që liron nga oxhaqet lëndë të dëmshme qëndron mbi rajonin e Pollogut një periudhë më të gjatë dhe rrezikon seriozisht shëndetin e banorëve.

Po ashtu e pranishme tek ne është edhe industria e ndërtimit si çimento, tulla, qeramika, gëlqere, qelqi dhe të tjerët, këto janë ndërmarrje që në masë të madhe ndotin ajrin atmosferik, për arsye se lirojnë një sasi të madhe pluhuri në natyrë. Fabrika e çimentos në Shkupit “USJE” në rastë se filtrat nuk punojnë, çdo ditë mbi qytet do të ishte hedhur rreth 600 ton pluhur, ose 14 ton në orë vetëm nëse një filtër oxhak nuk punon. Mund të themi se industrializimi është njëri nga faktorët që sot ambientin e kemi të ndotur.

Në vitin 2006, Sir Nicholas Stern, ish-shefi ekonomist i Bankës Botërore, lëshoi një studim në emër të qeverisë britanike mbi kostot e ndryshimeve klimatike globale. Ishte një nga paralajmërimet më të forta deri tani nga një raport i qeverisë. Ai tha, "Dëshmitë shkencore tani janë shumë të mëdha, ndryshimi i klimës është një kërcënim serioz global dhe kërkon një reagim urgjent global." Stern vlerësoi se nëse nuk veprojmë së shpejti, kostoja e menjëhershme e ndryshimit të klimës do të jetë së paku 5 për qind të GDP-së botërore çdo vit. Nëse merret parasysh një gamë më e gjerë e rreziqeve, dëmi mund të jetë i barabartë me 20 përqind të ekonomisë globale vjetore. Kjo do të shkatërronte ekonominë dhe shoqërinë tonë në një shkallë të ngjashme me luftërat e mëdha dhe depresionin ekonomik të gjysmës së parë të shekullit të njëzetë.²⁶

2.2.2 Karakteristikat kohore dhe sezonale të kriminalitetit ekologjik

Kriminaliteti si dukuri komplekse shoqërore, shpreh edhe disa veçori dhe karakteristika kohore. Shumë autorë në këtë drejtim kanë hulumtuar dhe vërtetuar në kërkimet empirike, se kriminaliteti dallohet prej kohës në kohë, vërehen karakteristika të veçanta të kriminalitetit gjatë natës, ditës apo sezonës.²⁷ Siç e cekëm edhe më lartë, ngrohja termike gjatë kohës së dimrit në rajonin e Pollogut bëhet kryesisht me lëndë djegëse drunjë që lëshojnë nga oxhaqet tym me përbërje helmuese, kurse gjithashtu gjatë periudhës së dimrit ajri është në shumicën e kohës i dendur, kurse mundësit për qarkullim të ajrit janë të vogla dhe atëherë na paraqitet një ajër tepër i ndotur me përbërje të rrezikshme kancerogjene.

²⁶ William P. Cuninghame & Mary Cuninghame - "Environmental Science - A Global Concern 12th Edition" fq. 341

²⁷ Halili Ragip, "KRIMINOLOGJIA", Prishtinë, 2011, fq. 127

Prerja e paligjshme e drunjëve quhet e paligjshme kur bëhet pa lejen e organeve kompetente. Ky fenomen është i pranishëm në vendin tonë për arsye të ndryshme ekonomike dhe shoqërore duke parë dhe çmimet e drunjëve në tregun e ligjshëm. Jo çdo familje mund të ketë ato kushte që të blejë drunjë, kurse dimri në vendin tonë është karakteristikë për temperatura të ulëta, në sezonën e vjeshtës kemi një numër të madh të prerjes së pyjeve për të siguruar ngrohje gjatë dimrit, por kjo nuk do të thotë se edhe gjatë stinëve të tjera nuk paraqitet ky fenomen.

Sipas regjistrimit të fundit zyrtar në vend ka 559,187 objekte qëndrimi. Sipas një sondazh i bërë në 2015 (Zyra Shtetërore e Statistikave, 2015) nga numri i përgjithshëm i familjeve, 62% përdorin dru si burim primar të nxehtësisë, 29% përdorin energji elektrike, 8% janë të lidhur me ngrohje qendrore, ndërsa pjesa e mbetur prej 1% përdor një lloj tjetër të burimit të nxehtësisë.²⁸

Me gjueti të pa ligjshme nënkuptojmë gjuajtjen e shtazëve të egra në kohën kur është e ndaluar gjuetia me ligj, ose gjuatjes e shtazëve të cilat janë të mbrojtura dhe që konsiderohen me ligj si të palejuara për tu gjuajtur për shkak të rrezikimit të zhdukjes së tyre, në të shumtën e rasteve të veprimeve të jashtëligjshme që bëhen në këtë aspekt i kemi në rastin kur gjuetia është në sezonin e ndaluar për gjuajtje, mirëpo edhe kur është sezona e lejuar nuk kemi një kontrollë të vazhdueshëm për të ndjekur atë se çfarë gjuhet nga gjuetarët, ky fenomen është shumë i pranishëm në vendin tonë, kurse shumë shtazë janë në zhdukje e sipër duke pasur parasysh se malet tona kanë pasur një shumëllojshmëri të shtazëve të egra që kanë jetuar në to.

Kur bëhet fjalë për krimet kundër mjedisit jetësor gjithmonë aludohet në gjininë mashkullore, mirëpo enti për statistik i Republikës së Maqedonisë gjatë përpunimit të të dhënave gjatë 5 viteve 2010-2015, ka arritur të sigurojë një numër të personave të paraqitur për kryerje të vepave penale kundër mjedisit dhe natyrës ku prej numrit të përgjithshëm si femra janë identifikuar 35 raste, diku me mesatare ndër 5% nga gjithë paraqitjet. Kurse numrin më të madh nga përqindja e femrave i hasim në veprat penale Ndotja e mjedisit dhe natyrës, por edhe tek torturimi i kafshëve etj. Nga këto statistika vërtetojmë të kundërtën e përshtypjes së krijuar se krimet kundër mjedisit dhe natyrës kryhen gjithmonë nga ana e gjinisë mashkullore. Duhet patjetër të cekim se në i Republikën së Maqedonisë nuk kemi raste të paraqitura ku kryerës të

²⁸ ²⁸ Raporti vjetorë nga të dhënat e përpunuara për kualitetin e mjedisit jetësorë, Shkup, 2016, fq.36

veprave penale kundër mjedisit janë fëmijë, domethënë gjithonë këto krime kryhen nga ana e personave madhorë.

2.2.3 Karakteristikat regjionale të kriminalitetit ekologjik

Në literaturë kriminologjike ekzistojnë disa mendime për të ashtuquajturat rajone të veçanta kriminale, në të cilat kriminaliteti është më tepër i shprehur. Në rastin tonë mund të themi se në qytete kemi dominim të veprave të kundërligjshme me qëllim dhe pa qëllim. Koha moderne ka sjellur shumë të mira në shoqëri sot, duke shijuar çdo send të freskët që sjell natyra pa mos u munduar aspak ato na sjellin edhe nëpër banesa ku jetojmë, në dimër mund të shijojmë të mirat tropikale, të cilat mund të prodhohen vetëm në vende të ngrohta, si dhe çdo ushqim që ekziston na e sjellin në vend, dhe nga gjithë këto të mira krijohet edhe një numër i madh i mbetjeve të cilat i quajmë mbeturina, kurse menaxhimi me to është paksa i vështirë për komunat dhe ndërmarrjet që merren me menaxhimin e tyre, mirëpo edhe vetëdija e qytetarëve duhet të jetë e ngritur sa i përket aspektit të mbeturinave, sepse ato nuk duhet të hidhen kudo, duke marrë parasysht dëmtimet që mund të vijnë. Në qytetin e Tetovës shumë vite me rradhë paraqitet ky fenomen, ndërmarrja për menaxhim me mbeturina e ka të vështirë asgjësimin ose reciklimin e tyre për arsye të rritjes së sasisë së mbeturinave, gjë që numri më i madh i tyre mbledhet në qytete sesa nëpër fshatra. Gjithashtu qytetet janë më të prekura nga ajri i ndotur që vijnë si pasojë e nxjerrjes së tymit nga automobilat. Në krahasim me vendet rurale në qytet kemi një frekuentim më të madh të numrit të makinave për arsye nga më të ndryshmet, duke përmendur këtu edhe kolonat e shumta të cilat krijohen gjatë ditës nëpër qytete.

Në disa rajone janë më të shprehura disa lloje krimesh, kurse në rajone tjera dukuri tjera kriminale, në këtë drejtim shpesh herë në literaturë kriminale përdoret termi Zona kriminale përmes së cilët dëshirohet të theksohen disa rajone, ku kriminaliteti është më tepër i pranishëm se sa në rajonet tjera. Për këtë arsye ka mendime se duhet të konstituohet një disiplinë e vecantë kriminologjike e cila do të merret vetëm me studimin e shpërndarjes teritoriale dhe regjionale të kriminaletetit dhe ajo të quhet Gjeografi kriminale.²⁹

²⁹H.D Schwind vep. E cit. fq.263-267

KAPITULLI I TRETË

FORMAT DHE SHKAQET E PARAQITJES SË KRIMINALITETIT EKOLOGJIK NË RAJONIN E POLLOGUT

3.1 Format e kriminalitetit ekologjik në rajonin e Pollogut

Krimi mjedisor është një problem serioz ndërkombëtar, i cili manifestohet në forma të ndryshme, të cilat nuk janë të kufizuara vetëm brenda ajrit, ujit dhe tokës por deri në zhdukjen e florës dhe faunës, veprime që përshpejtojnë ndryshimin e klimës, ulje drastike në rezervave të peshkut, shkatërrimi i pyjeve dhe si dhe madje edhe shkatërrimi i burimeve natyrore. Sipas autores Milana Pisarit format e krimit mjedisor mund të ndahen kushtimisht në dy kategori:

- ✓ Kontrabandim me resurse natyrore- e cila përfshinë tregëtinë me specie të rrezikuara, prerjet ilegale dhe shfrytëzimit të paligjshëm dhe tregëtimin e resurseve minerale.
- ✓ Kontrabandim me materialeve të rrezikshme- e cila përfshinë tregëtinë e paligjshme me substancat që hollojnë shtresën e ozonit dhe asgjësimin e mbeturinave dhe tregtisë.³⁰

Për të zbërthyer më mirë këtë kriminalitet do të duhet t'i qasemi aspektit kriminologjik. Kriminologjia është shkenca mbi kriminalitetin dhe dukuritë e ngjashme të dëmshme shoqërore. Për dallim nga shkencat tjera penale ajo merret me studimin e shkaqeve por edhe të formave të manifestimit, strukturës dhe zhvillimit të kriminalitetit. Dukuritë tjera sociale-patologjike, studion po aq sa edhe janë në lidhje të ngushta me kriminalitetin apo i kontribuojnë të kuptuarit më të mirë të tij. Kriminologjia, për shkak të fushëveprimit të tillë ndahet në dy fusha themelore:

1) Etiologjia kriminale e cila studion faktorët kriminogjen dhe kushtet e përgjithshme të lindjes së kriminalitetit dhe

³⁰ Milani Pisara, "Luftimin ndërkufitar i krimit mjedisor", Beograd, fq.4"

2) Fenomenologjia kriminale, e cila studion format e manifestimit të krimit. Kriminaliteti konsiderohet si dukuri shoqërore sepse paraqet veprim njerëzor të ndërlidhur.³¹

Kur flitet për fenomenologjinë kriminale shtrohet nevoja për klasifikimin dhe ndarjen e formave të manifestimit të sjelljeve kriminale. Kriteret për klasifikimin dhe ndarjen e sjelljeve kriminale janë të ndryshme. Ato kriteret shpeshvaren prej autorëve, drejtimeve dhe shkollave të ndryshme kriminologjike. Mirëpo si kriter i shpesht merret i ashtuquajti klasifikim ligjor, ose klasifikim juridiko-penal i veprave penale sipas emërimeve dhe ndarjeve në ligjet pozitive. Kjo ndarje në një mënyrë është më e lehta dhe më e sigurt.³²

Sipas klasifikimit juridiko-penal veprat penale kundër mjedisit jetësor dhe natyrës janë të ndara si vijon: ndotja e mjedisit jetësor dhe natyrës, ndotja e ujit të pijshëm, prodhim i mjeteve të dëmshme për mjekimin e shtazëve dhe gjallesave, dhënia e pandërgjegjshme e ndihmës veterinarë, bartja e sëmundjeve ngjitëse në botën bimore dhe shtazore, ndotja e ushqimit ose ujit për kafshët, shkatërimi i të mbjellave me përdorim të materive të dëmshme, uzurpimi i paluajtshmërive, eksploatimi joligjor i lëndëve të para minerale, shkretimi i pyllit, shkaktimi i zjarrit në pyll, gjuetia e paligjshme, peshkimi i paligjshëm, rrezikimi i mjedisit jetësor dhe natyrës me hedhurina, furnizimi dhe zotërimi i paautorizuar i materive nukleare, transportimi i materive të rrezikshme në vend, mundimi i kafshëve dhe vepra të rënda kundër mjedisit jetësor dhe natyrës.

Në literaturën kriminologjike përmenden edhe shumë klasifikime tjera mirëpo ne do t'i ndajmë në 3 grupe kryesore këto vepra:

- ✓ Ndotja e ajrit
- ✓ Ndotja e tokës
- ✓ Ndotja e ujit

³¹ Abazovic Mirsad, "Politika e Luftimit të kriminalitetit", Sarajevë-Prishtinë, 2006, fq. 10"

³² R. Gassin vep e cit fq. 281-283 dhe 284-285

3.1.1 Ndotja e ajrit

Është e vështirë të jepni një përkufizim të thjeshtë dhe gjithë përfshirës të ndotjes. Fjala ndotje vjen nga gjuha latine, që do të thotë "bëhet i lig, i papastër ose i pistë". Disa autorë e përdorin termin vetëm për materialet dëmtuese që lihen në mjedis nga aktivitetet njerëzore.³³

Ndotja e atmosferës është një fenomen që rrjedh nga zhvillimi i shpejtë teknologjik dhe jeta njerëzore në epokën e industrializimit. Sidoqoftë, kemi përjetuar katastrofa natyrore (tërmetet, përmytjet, vullkanet, zjarret etj.) me rritjen e ndotjes së ajrit gjatë viteve të fundit. Është e njohur se aktivitetet njerëzore (burimet antropogjene) kanë ndikim të rëndësishëm në cilësinë e ajrit të ambientit në mjediset urbane dhe efektet e dëmshme mbi njerëzit, kafshët, bimët, ndërtesat dhe materialet. Ndotja e ajrit po intensifikohet gjithënjë e më shumë si rezultat i zhvillimit të shpejtë të trafikut, djegie jo të plotë të mbeturinave, industrisë, urbanizimit të shpejtë, kujdesit të pamjaftueshëm për ruajtjen e mjedisit etj. Është e qartë se ndotja e ajrit nuk është vetëm një çështje lokale .

Transferimi i ndotjes i shkaktuar nga lëvizjet atmosferike mund të shkaktojë efekte të dëmshme në një distancë të gjatë. Një pjesë e madhe e ndotjes vjen nga burime të vendosura disa mijëra kilometra larg. Çdo vit miliona ton dioksid sulfuri, okside azoti, monoksidi i karbonit, grimcat e ngurta dhe gazrat që shkaktojnë efektin serrë dhe hollojnë shtresën e ozonit, emetohen në shtresën tokësore të ajrit dhe atmosferës dhe ato njihen si ndotës primarë të ajrit. Ajri i ndotur shkakton pasoja të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe organizmave të tjerë të gjallë, si dhe mjedisin e tyre, gjithashtu shkakton dëme në ekonominë e njeriut të jetesës. Prandaj, është e nevojshme të përgatiten plane dhe programe në të cilat do të përcaktohen masat për mbrojtjen e cilësisë së ajrit dhe zbatimi i tyre do të zvogëlojë sasinë e ndotësve.³⁴

Në një raport të ri të publikuar për Konferencën e Klimës në Paris nga Agjencia Evropiane e Mjedisit (EEA) në Kopenhagë, vlerësohet se 430,000 vdekje të parakohshme në vit në Evropë lidhen me ndotjen e ajrit. Ndotja e ajrit vazhdimisht dëmton shëndetin e qytetarëve dhe iu shkurton atyre të mirat dhe jëtëgjatësinë. Gjithashtu rritet numri i atyre të cilët kërkojnë shërbime shëndetësore dhe i personave të mungojnë në punë për shkaqe shëndetësore dhe kjo redukton edhe produktivitetin e ekonomisë. Ndotja e ajrit përbën, sipas Agjencisë Evropiane të

³³ "William P. Cuninghame & Mary Cuninghame - "Environmental Science - A Global Concern 12th Edition" fq. 349

³⁴ "Statistika për mjedisin jetësor 2015", Shkup fq. 79

Mjedisit (EEA) rrezikun më të madh shëndetësor të varur prej mjedisit në Evropë".Përveçse i shkurton jetën njerëzve, ndotja e ajrit favorizon sëmundje të rënda, si sëmundje të zemrës, të rrugëve të frymëmarrjes dhe kancerin.

Më shumë se 1 në 4 vdekje të fëmijëve nën moshën 5 vjeçare i atribuohen një mjedisi të pashëndetshëm. Çdo vit, rreziqet mjedisore, si ndotja e ajrit brenda dhe jashtë shtëpisë, duhanpirja pasive, uji i papastër, mungesa e higjienës dhe higjiena e papërshtatshme marrin 1.7 milion jetë fëmijësh nën moshën 5 vjeçare, thonë dy raporte të reja të OBSH-së.

Mjekët konstatojnë se një numër i madh i sëmundjeve në trupin e njeriut vijnë nga ajri i ndotur si përshembull :

- ✓ Sëmundje të sistemit nervor:Dobëson funksionet motorike dhe të vetëdijes,sulme dhe kriza nervore.
- ✓ Sistemi i frymëmarrjes:sëmundje kronike dhe akute të frymëmarrjes,dëmtim i mushkërive, kanceri i mushkërive,bronhit dhe astma.
- ✓ Sistemi urinar:dëmtimi i mëlçisë dhe veshkëve.
- ✓ Sistemi kardiovaskular:sëmundje të zemrës dhe sulme në zemër.
- ✓ Sistemi riprodhues: Tek femrat- Çregullim gjatë lindjes,vdekshmëria e foshnjëve dhe rrezik për kancer, kurse tek meshkujt-inferlitet dhe rrezik për kancer.

Fakti se ndotja e ajrit mund të mos duket me sy të lirë, nuk do të thotë se ajo nuk ekziston.Për shembull sa herë që shohim Tetovën nga Kodra e Diellit kuptojmë më qartë se ku jetojmë dhe çfarë ajri thithim,sesa kur jemi në Tetovë.Ndotja në rajonin e Pollogut ka arritur kulminacionit në kohën e fundit duke alarmuar edhe organizatat botërore për gjendjen e jashtëzakonshme në Tetovë, që për disa javë edhe shkollat u mbyllën kurse qytetarët kishin frikë të dalin jashtë në qytet,kurse fajtor kryesor mendohet të jetë fabrika industriale “Jugohrom Ferroalloys” me lokacion në Komunën e Jugonofcës, gjegjësishtë në fshatin Jugonofcë.

Jugohrom Ferroalloys, i cili tregohet nga banorët si shkatërruesi i ajrit, jetës dhe mjedisit, është një kombinat i vjetër që përdor djegien e qymyrit për prodhimin e aliazheve të nikelit dhe nikel-silicit.Kombinati është prej disa vitesh nën pronësi të një grupi nga Rusia pas privatizimit dhe konsiderohet si një nga dinozaurët e industrisë së rëndë të trashëguar nga ish-Jugosllavia.Ku

si shkaktari kryesor mendohet se ka liruar një sasi të madhe të grimcave kancerogjene nga oxhaqet e saj të pa filtruara dhe përmes erës janë bartur në të gjithë rajonin e Pollogut. Gjatë matjeve të ajrit nga organet e posaçme vërehej prezencë mbi normale e grimcave pm10 si dhe LPM.

PM10 dhe LNP janë dy nga indikatorët më të rëndësishëm të cilësisë së ajrit. Ata shprehin sasinë e grimcave të ngurta pezull në ajër. PM10 (Particulate Matter) është një përzierje pjesëzash të lëngëta dhe të ngurta që qëndrojnë në ajër, me një diametër më të vogël se 10 mikrometër. Burimi kryesor i tij janë gazrat e çliruara nga automjetet, sidomos nga makinat e vjetra me motor diesel, mund të shkaktojë përkeqësim të sëmundjeve kardiovaskulare dhe të frymëmarrjes, sulme në zemër dhe aritmi. Mund të shkaktojë kancer. Kjo mund të çojë në arteriosklerozë, në rezultatet e kundërta në të sapolindurit dhe në sëmundjet e frymëmarrjes tek fëmijët. Rezultati mund të jetë vdekja e parakohshme. LNP (Lënda e Ngurtë Pezull) është një indikator, i cili shpreh prezencën e grimcave të pluhurit në ajër. Burimi kryesor i tij janë ndërtimet e shumta dhe rrugët e pa shtruara.³⁵

Tabela nr.2³⁶

Koncentrimi i grimcave të dëmshme në ajër (pm10) gjatë viteve 2012-2015 në Tetovë

Viti	Ndotja (grimcat pm10)
2012	152 mg/m ³
2013	150 mg/m ³
2014	134 mg/m ³
2015	146 mg/m ³

Duhet të kemi parasysh se niveli i lejuar i koncentrimit të grimcave të dëmshme në ajër sipas organizatave botërore është 50 mg/m³, kurse Agjencia ndërkombëtare për hulumtime të kancerit thotë se nëse niveli i këtyre grimcave rritet për 10mg/m³ atëherë shkalla e rrezikshmërisë nga

³⁵<http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/292/Cilesia-e-ajrit---prezenca-e-ndotesve-PM10-dhe-LNP>

³⁶ Matjet zyrtare të regjistruara nga Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor.

kanceri rritet për 22%. Kjo shpjegon faktin se përse Tetova shënon rritje rekorde nga sëmundjet me kancer ku vetëm për 3 vite këto sëmundje u rritën për 80%”.

Profesori universitar Mile Dimitrovski, thotë se masat e deritanishme për zvogëlimin e ndotjes së ajrit nuk kanë pasur aspak efekt, apo kanë qenë me afat të shkurtër dhe për politikë ditore. “Nuk ekzistojnë masa të shpejta që do të ndërmerreshin për të pasur rezultate pozitive rreth gjendjes së ndotjes në Tetovë dhe Shkup, ku gjatë dhjetë viteve të kaluara, janë udhëhequr politika të gabuara dhe masat që u ndërmorën nuk kishin asnjë efekt. Duhet që të largohet deponia në hyrje të Tetovës, ndërtimi i qarkoreve dhe rrugëve që do të lehtësonin komunikacionin e dendur si një nga shkaktarët e ndotjes. Nëse këto masa merren tash, atëherë rezultatet do t’i kemi pas dhjetë vitesh”

Numri i personave të sumurë nga kanceri në Tetovë gjatë viteve të fundit është rritur për 80%: 1313 në vitin 2010 kurse në vitin 2012 arrin numri i të vdekurve nga kanceri në 2268, kurse gjatë vitit 2013 vdesin nga kanceri 2375 persona. Siç edhe statistikatat tregojnë ajri i ndotur po vret shumë persona, si dhe shumë të tjerë preken me sëmundje të ndryshme në Tetovë dhe rrethinë. Sipas Eco Guerrila-s (organizat joqeveritare) pas mbylljes së fabrikës së “Jugohrom Ferroalloys” në qytetin e Tetovës niveli i ndotjes ka rënë dukshëm. Sipas matjeve të bëra nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, kur krahasojmë nivelin e ndotjes gjatë muajit shkurt 2015 dhe shkurt 2016, dallimi është 41%. Ndërsa ajo që habit është që në periudhën e njëjtë kohore, niveli i ndotjes në Shkup shënon një diferencë gati të padukshme - vetëm me 0,1%.

Një tjetër problem i cili i preukopon qytetarët e Tetovës është keq menaxhimi me mbeturinat e qytetit, të cilat janë të vendosura në deponi në hyrje të qytetit, kurse ajo zonë ka filluar të mbipopullohet, djegja e mbeturinave në atë vend i ngulfat qytetarët e asaj zone. Si dhe numri i madh i makinave të vjetra, që lëvizin nëpër qytet dhe lirojnë gazra helmues. Ekspertët thonë se këmbësorët shpesh nuk e kuptojnë se sa afër ndodhen pranë burimit kryesor të ndotjes.

Organizata Botërore e Shëndetësisë paralajmëron se 92% e popullsisë së botës jeton në zona me nivel të lartë të ndotjes së ajrit. Shumë qytete në Evropë kanë premtuar të heqin gradualisht makinat me naftë, si dhe ekziston shpresa që makinat elektrike do të hyjnë më shumë

në treg me përmirësimin e jetëgjatësisë së baterive³⁷, edhe në Republikën e Maqedonisë qeveria ka nxjerr ligje për subvencionimin e personave që blejnë vetura me energji elektrike duke ju larguar tatimet dhe duke ju ndihmuar në blerjen e makinave, kurse edhe shkaktar tjetër i madh gjatë sezonës dimërore është ngrohja me anë të djegies së drunjëve, i cili liron nëpër oxhaqet e shtëpiave helm. Sikur edhe për këto probleme të merren masa të shpejta niveli i ndotjes do të ulet mbi 80 %.

Në mënyrë që ta ruajmë ajrin sa më të pastër duhet me kujdes të zgjedhim mënyrën se si e shfrytësojmë energjinë dhe sa shumë karburate përdorim për industrinë, duke zgjedhur burim që gjatë procesit të shfrytësimit dhe përpunimit të dalin sa më pak mbetje të rrezikshme si dhe mundësia e riciklimit të tyre për të prodhuar diçka tjetër.

3.1.2 Ndotja e tokës

Ndotja e tokës i referohet një niveli në rritje të kimikateve të dëmshme të njeriut në mjedisin natyror të tokës. Ndotësit industrial dhe pesticidet janë dy burime kryesore të ndotjes së tokës. Kjo ndotje mund të na dërgojë deri tek ndotja masive e ujit të pijshëm dhe tek jetët e njerëzve dhe shëndeti i tyre të shkaktojë dëme të mëdha shëndetësore. Kurse riparimi i këtyre dëmeve kërkon mjete të mëdha financiare dhe mund të shumtë të ekspertëve nga të gjitha fushat kompetente dhe si proces është shumë afatgjatë dhe i mundimshëm. Nëse toka është e ndotur me metale të rënda si kromi dhe plumbi kjo mund të çojë në përhapje më të lartë të kancerit dhe leukemisë tek njerëzit. Për këtë shkak parandalimi i këtij lloji helmimi është i preferueshëm dhe më i shpejtë sesa procesi i gjatë i pastrimit të tokës. Mirëpo nëse toka është pothuajse e shkatëruar nuk do të thotë se ajo nuk mund të riparohet për këtë arsye edhe hulumtuesi Francez që merret me këtë problem Erik Lichtfouse thotë se riparimi e cilësisë së tokës së degraduar, të zhdukur, të varfëruar dhe të ndotur është thelbësore për plotësimin e kërkesave të një popullsie në rritje me aspirata në rritje për standardet e larta të jetesës.

Popullsia botërore parashikohet të arrijë në 9.2 miliardë deri në vitin 2050. Presioni mbi resurset e tokës për plotësimin e kërkesave të rritjes së popullsisë për ushqim dhe lëndë djegëse

³⁷ "http://www.mjedisisot.info/index.php/lajme-nga-bota/2394-makinat-me-nafte-shkaktare-kryesore-te-ndotjes-se-ajrit"

ka gjasa të përkeqësohet nga disa faktorë interaktivë. Ndër këto faktorë janë: (1) ngrohja globale, (2) degradimi i tokës, (3) rënia e furnizimit me ujë të freskët së bashku me ndotjen e burimeve ujore, (4) ndërhyrja urbane dhe industrializim.³⁸

Për të mundësuar riparimin dhe vlerësimin e tokës së dëmtuar duhet të bëhet monitorimi i tokës në përgjithësi siç thot shkencëtari Ibrahim A. Mirsal: Monitorimi është mbikëqyrja e rregullt dhe përcaktimi i sasisë së ndotjes së pranishme në një vend të caktuar të tokës. Ajo duhet të kryhet në një mënyrë, që mundëson zbulimin e ndryshimeve hapësinore si dhe kohore në përqëndrimin e ndotësve në vendin e hetimit. Monitorimi duhet të japë informacion mbi: • Natyrën e ndotësve, sasisë, burimet dhe shpërndarjen e tyre • Efekti i ndotësve. • Modelet e përqendrimit, ndryshimet pedologjike dhe shkaqet e tyre • Mundësia dhe realizueshmëria e rikuperimit. Mund të kryhet duke përdorur metoda fizike, kimike ose biologjike.³⁹ Mirëpo këto të dhëna në vendin tone na mungojnë.

Sipërfaqja e përgjithshme e Republikës së Maqedonisë është 25,713 km², ku 24,856 km² të kësaj sipërfaqeje janë tokë ndërsa 477 km² ujë. Kurse pyjet janë më të përhapura në zonat malore. Ato mbulojnë më shumë se 906,000 hektarë ose 35% të sipërfaqes së përgjithshme të Republikës së Maqedonisë. Nga sipërfaqja e përgjithshme e territorit të Republikës së Maqedonisë, tokë bujqësore zënë 1,265.000 hektar tokëose 4.9%, tokë e punueshme zënë 560,000 hektar ose vetëm 2.2% të territorit të përgjithshëm të Republikës së Maqedonisë.

Prej tokës direkt janë të varura të gjithë gjallesat e tokës si dhe flora dhe fauna, të kushtëzuar nga kjo njeriu i vetëdijshëm për pasojat duhet të ruaj vetë ciklin e zhvillimit të jetës në tokë për një zhvillim të qëndrueshëm, duke arrit që me rritjen e kërkesave, si dhe rritjen e popullsisë kjo tokë që e kemi në shfrytëzim t'i kënaqë nevojat e përgjithme, mirëpo mendohet se nëse nuk merren masa për mbikëqyrjen e zhvillimit të qëndrueshëm atëherë toka nuk do të ketë mundësi që të na shërbejë, për shkak se numri i popullsisë shkon duke u shtuar kurse sipërfaqet pjellore sa vijnë dhe zvogëlohen dhe helmohen nga ana e industrive të mëdha me anë të pesticideve dhe helmeve të ndryshme bujqësore, kurse në anën tjetër për të arritur kërkesat për pemë dhe perime të freskëta bujqit janë të detyruar të përdorin lloje të ndryshme të ilaçeve

³⁸ "Eric Lichtfouse," Editor Organic Farming, Pest Control and Remediation of Soil Pollutant", France, 2008, fq. 5"

³⁹ Ibrahim A. Mirsal, "Soil Pollution Origin, Monitoring & Remediation", fq. 172

artificiale në bujqësi, kurse produktet që rriten në mënyrë artificiale nuk kanë shijen dhe vitaminat e nevojshme si ato që rriten në mënyrë natyrale, duke marrë parasysh këtë sa vijnë e shtohet numri i njerëzve, që kërkojnë që të shërbehen me produkte bio natyrale. Në Evropën perendimore sa vijnë e shtohen shitoret me produkte natyrale mirëpo çmimet e tyre në krahasim me ato që bëhen në mënyrë të shpejtuar dallojnë dhe jo çdokush mund t'i blejë ato.

Deponi të egra në vitin 2011 që nga ana e 24 komunave raportuan një total prej 503 deponive ilegale në territoret e tyre me një sipërfaqe totale prej 54.47 hektarësh ose 544.669 m² dhe sasi shtesë të mbeturinave nga 7.787 m³. Deponitë më të mëdha ilegale raportohen në komunën e Tearcës me sipërfaqe nga 178.200 m², më tej në Brvenicë me një sipërfaqe prej 175.200 m².⁴⁰

Duke qenë të vetëdijshëm se tokat pjellore kanë nevojë për ujë që bëhet nga ana e shiut si dhe nga vetë njeriu duke ujitur ato nga rrjedhat e lumenjve dhe përrojeve, kurse ujrat janë të ndotur me fekale që vetë njeriu i lëshon në mungesë të kanalizimeve ato e bëjnë tokën joproduktive me substanca të dobëta ushqyese, kurse nga aspekti shëndetësor janë të dëmshme ato produkte që dalin nga ajo tokë, sepse përmbajnë sëmundje ngjitëse. Kurse në rastet tjera edhe uji i tepërt i rëmbimeve ose rreshjet e mëdha të shiut e dëmtojnë tokën pjellore. Toka mund të dëmtohet edhe nga mungesa e ujit dmth thatësisë, është e vlerësuar se për shkak të thatësisë janë dëmtuar rreth 70 milion km², për këtë shkak shumë njerëz në botë sot janë të urritur. Uria është dukuri e njohur qysh nga lashtësia dhe ka të bëjë me mungesën e ushqimit. Kjo dukuri bëhet e dukshme atëherë kur njerëzit vdesin nga uria.

Uria e nënkupton edhe dukurinë e mungesës së nevojshme të ushqimit për njerëzit. Njeriut për të pasur shëndet të mirë i nevojiten 2500 kalori në ditë, kurse kufiri i poshtëm konsiderohet sasia prej 1600 kalori. Mesatarja e kalorive të shpenzuara në ditë në vendet e zhvilluara është mbi 3000 kalori, kurse në vendet në zhvillim rreth 2000 kalori, ndërsa në vendet e pazhvilluara nën këtë kufi. Në Afrikë janë 172 milion banorë të uritur ose jo mjaft të ushqyer (rreth 25% e popullsisë gjithsej). Mungesa e ushqimit ndihet në vendet që nuk e kanë shtuar prodhimin, ato që nuk kanë mundësi importi (nuk kanë deviza), që nuk kanë mundësi transporti, që nuk kanë sipërfaqe të mjaftueshme të punës, që nuk kanë ekonomi të zhvilluar, ose që janë prekur nga luftërat qytetare ose rajonale (Somalia, Sudani, Ruanda, Angola, Zairi, Liberia etj).⁴¹

⁴⁰ Raporti vjetorë nga të dhënat e përpunuara për kualitetin e mjedisit jetësorë, Shkup, 2011, fq.91

⁴¹https://sq.wikipedia.org/wiki/Problemi_i_uris%C3%AB_n%C3%AB_bot%C3%AB

Ndotja e tokës është e lidhur ngushtë edhe me ndotjen e ujit dhe ajrit, prerja e drunjëve dhe shkretimi i pyjeve pamundësojnë filtrimin ajrit përmes procesit të fotosintezës si dhe bëjnë kushte të favorshme për vërshime. Çdo dru i prerë kontribon në rritjen e ndotjes, në rritjen e sëmundjeve, në rritjen e kancerit, dhe në rritjen e vdekjeve nga këto sëmundje. Adaj është shumë e dobishme që të merren masa në pyllëzimin e zonave të zveshura, e para për t'ju shmangur shembjes së mundëshme të tokës, dhe e rëndësishme është se bëjnë pastrimin e ajrit. E rëndësishme është që nëpër qytete të shtohen sa më shumë hapsirat e gjelbërta, e po ashtu qyteti vjen e rritet, këtë trend e shohim viteve të fundit, e rëndësishme është që komuna bashkë me qeverinë të përpilojnë planin që kjo rritje të bëhet në gjërësi të qytetit dhe jo në lartësi. Sa më tepër që qyteti rritet në lartësi aq më tepër rritet edhe ndotja e tij.

3.1.3 Ndotja e ujit

Dihet se 71% të sipërfaqes së planetit tonë është e mbuluar me ujë, po ashtu dihet se jeta është shfaqur në ujë dhe është e lidhur ngushtë me ujin. Prandaj, ndotja e ujit është e rrezikshme jo vetëm për njeriun, por edhe për organizma të tjerë. Ndotja e ujit mund të jetë fizike, kimike dhe biologjike. Si kriter për përcaktimin e cilësisë së ujit merren treguesit fizikë, kimik dhe biologjik.

- Tregues fizikë të ndotjes së ujit janë: temperatura, era, shija, ngjyra, transparenca, përcjellshmëria elektrike e ujit etj.
- Tregues kimik i cilësisë së ujit merret vlera e Ph (aciditeti dhe alkaliteti ose baziteti), pastaj stabiliteti dhe agresiviteti (fortësia) i ujit.
- Tregues biologjik të ndotjes së ujit merret prania e viruseve, e bakteve, këpurdhave, nematodave, insekteve etj.

Rëndësia e ujit për qeniet e gjalla dhe planetin është i shumfishtë: ai është mjedis jetësor në të cilin jetojnë shumë qenie të gjalla, është burim i ushqimit dhe i materieve të domosdoshme minerale, është edhe burimi i resurseve energjetike.

Uji është materie e pazavendësueshme, andaj duhet të kujdesemi që mos e ndotim, mirëpo uji qarkullon vazhdimisht dhe me këtë ai edhe kontaminohet me: gazra toksike, mikroorganizma, materie minerale e radioaktive. Në ditët tona uji kontaminohet më tepër nga komunikacioni ujor, agrokemikatet sik janë: pesticidet dhe plehrat artificiale nga tokat bujqësore, sapunet detergjentet, zbërthyesit nga amvisëria dhe fabrikat, pastaj metalet p.sh., plumbi

dhe zhiva, po ashtu ndotja vjen edhe nga proceset industriale, agjensat infektive si dhe temperatura. Gjithë këto substanca të themi fillimisht ndotin ujin e lumit dhe siç e dimë lumi lidhet me detin dmth kontaminohet edhe deti dhe pastaj edhe oqeanet.

Duhet theksuar se lumenjtë çdo vit bartin sasi të mëdha të dheut i cili përmban materie kimike si plehra, pesticide dhe insekticide. Burimet e ndotjes janë mbeturinat e ushqimit, hedhurinat industriale, teknologjike dhe kanalizimet e qyteteve.

Ujërat në afërsi të qyteteve përmbajnë mikroorganizma, ku këto mikroorganizma mund të vendosen në indet e peshqëve dhe guacave me të cilat njerëzit infektohen pas konsumimit. Sot në botë për çdo vit sëmuren me mijëra persona nga sëmundjet që barten me ujë. Ndotja është prezente gati çdokund rreth qyteteve të mëdha.

Nëse analizojmë territorin e Komunës të Tetoves ka dy lumenjë më të mëdhenjë: Vardarin dhe Shkumbinin, me të kaluar nga këto lumenjë mund të shohësh se si notojnë gjësende të ndryshme materiale duke filluar nga: shishet e plastikës, materiale prej druri e deri në ekstrem ku disa qytetarë kanë fotografuar se si në këto lumenjë notojnë edhe mobilje shtëpiake. Po ashtu kemi edhe të dhëna të cilat nuk janë zyrtare se në lumin Shkumbin i cili kalon në afërsi të spitalit derdhen edhe shumë mbeturina të spitalit, mirëpo askush deri më tani nuk e ka shpalosur në publik dhe me këtë edhe nuk janë marrë masa adekuate. Mbetjet e aborteve ose e shiringave sdomend se paraqesin një burim më të madh të ndotjes së ujit.

Në përputhje me legjislacionin aktual në fushën e menaxhimit të mbeturinave mjekësore institucionet shëndetësore që prodhojnë mbeturina mjekësore janë të detyruar të dorëzojnë një herë në vit raportin për trajtimin e mbeturinave në Ministrinë e mjedisit dhe planifikimit hapësinor. Sipas të dhënave të paraqitura nga institucionet shëndetësore në Republikën e Maqedonisë sasia e mbetjeve mjekësore të prodhuara për vitin 2016 është 712,24 ton. Sipas raporteve të dorëzuara për trajtim të mëtejshëm me mbetjet mjekësore, domethënë sasia e mbetjeve mjekësore të dorëzuara është 698.60 ton ndërsa shuma e mbetur prej 13.64 ton trajtohet automatikisht për mbetjet e lëngëta. Ne për të arritur në përfundimin se në Republikën e Maqedonisë mbetjet mjekësore që janë dorëzuara sipas raporteve të dorëzuara trajtohen dhe neutralizohen siç duhet kurse mos dorëzimi i tyre paraqet një rrezik të drejtpërdrejtë për mjedisin dhe njerëzit. Gjithashtu duhet të theksuar se sasi të mbetjeve të paraqitura nuk përfaqësojnë sasi të përgjithshme të mbeturinave gjeneruan mbeturina mjekësore në nivel të Republikës së Maqedonisë.

Tabela nr.3⁴²

Sasia e mbeturinave mjekësore të paraqitura sipas viteve.

Viti	Sasia (ton)
2010	195.6
2011	355.87
2012	444.78
2013	611.32
2014	584.94

Siç shihet në Tabelën 2, sasia e mbetjeve të gjeneruara në 7 vitet e fundit është rritur gradualisht, nga e cila mund të konkludohet se numri i krijuesve të mbeturinat e rrezikshme mjekësore që sipas ligjit në fushën e menaxhimit mjekësor mbetjet e detyruara për të dorëzuar një herë në vit një raport mbi trajtimin e mbeturinave është rritur

Organizata Botërore të Shëndetësisë raporton se mjedisi i ndotur mbyl 1.7 milionë fëmijë të moshës nën pesë vjeçare si pasojë e ndotjes në tërë botën, ndërsa në Maqedoni duke llogaritur numrin e përgjithshëm të banorëve në vend (rreth 2 milionë banorë), kjo do të thotë se te ne 540 fëmijë të moshës nën pesë vjeç në vit e humbin jetën për shkak të ndotjes.

Në raportin e OBSH-së shtohet se një nga katër raste të vdekjeve të fëmijët të moshës nën pesë vjeçe atribuohen në ndotjen e ajrit dhe ujit dhe në kushtet e këqija sanitare. Shkaqet më të shpeshta për vdekje të fëmijët janë diarea, pneumonia dhe malaria. Çdo vit 361.000 fëmijë vdesin nga diarea, për shkak higjienës së dobët dhe qasjes së kufizuar për sigurimin e ujit për pije. Drejtori i OBSH-së, Margret Çan deklaroi se “Mjedisi i ndotur është vdekjeprurës, veçanërisht të fëmijët. Zhvillimi i tyre në organet dhe sistemi imunitar, si dhe volumi më i vogël në rrugët e frymëmarrjes, i bën të prekshëm nga uji dhe ajri i pistë”.

Nga këto të dhëna mund të kuptojmë rëndësinë e ruajtjes së ambientit ku jetojmë, pasi ndotja e tij ka lënë shumë pasoja e në disa raste edhe pasoja fatale. Andaj është e preferueshme

⁴² Raporti vjetorë nga të dhënat e përpunuara për kualitetin e mjedisit jetësorë, Shkup, 2016, fq.110

që vetë shteti të formojë projekte të cilat sadopak do fillojnë të zbusin ndotjen e ujit në Republikën e Maqedonisë.

3.2 Shkaqet e paraqitjes së kriminalitetit ekologjik

Shkaqet të sjelljes kriminale konsiderohen të gjitha ato rrethana dhe ndikime që e shtyejnë individin apo grupet në veprime kriminale. Këto rrethana dhe ndikime janë me fuqi vendimtare dhe ato zakonisht nxisin aktivitetin kriminal të individit apo grupeve të cakutuara.⁴³ Rrethana të këtilla në litaraturën kriminologjike përmenden kushtet ekonomike, sociale, politike, sociopatologjike etj. Krimi konsiderohet si dukuri masive dhe individuale. Ndonjëherë p.sh. lidhur me procedurën penale kundër ndonjë delikuenti, pikëqëndrimi i studimit vihet në kriminalitetin si dukuri individuale, gjegjësisht si sjellje personale psikike dhe fizike.

Tek konsiderimi i kriminalitetit si dukuri masive ndodh nganjëherë që dukuria e tillë masive të trajtohet si përmbledhje e thjeshtë e sjelljeve individuale kriminale, sidomos me rastin e aplikimit të metodave statistikore. Kjo megjithatë nuk e sjellë në pyetje karakterin e kriminalitetit si dukuri shoqërore.

Kriminaliteti është dukuri shumë komplekse i cili përveç aspekteve të përmendura sociale dhe juridike i ka edhe aspekte tjera të ndryshme, sidomos ato psikologjike, psiko-patologjike dhe biologjike. Kjo prandaj, sikurse që studimi i kriminalitetit si dukuri shoqërore individuale, kërkon aplikimin e metodave dhe teknikave të ndryshme kërkimore. Në këtë fushë krahas metodave statistikore sidomos është zhvilluar metoda e studimit individual të rastit dhe metoda klinike të cilat paraqesin thellimin dhe studimin e drejtpërdrejtë të rastit të tillë. Si shembull i këtyre faktorëve mund të shërbej varfëria, begatia, familja e shkatërruar, diferencat dhe konfliktet kulturore, frustrimi, labiliteti emocional. Për kriminalitetin dhe shkaktarët e tij, format e paraqitjes dhe pengimin e tij është menduar dhe shkruar gjatë shekujve të kaluar kryesisht në kuadër të mësimave filozofike juridike dhe teologjike.⁴⁴

⁴³ Halili Ragip, "Kriminologjia", Prishtinë, 2011, fq. 239

⁴⁴ Abazovic Mirsad, "Politika e Luftimit të kriminalitetit", Sarajevë-Prishtinë, 2006, fq. 11

Kriminalistika është disiplinë shkencore e cila, me qëllim të aplikimit praktik, merret me studimin e mjeteve dhe metodave të zbulimit dhe shpjegimit të veprave penale, me zbulimin e kryersve të tyre me sigurimin dhe vërtetimin e dëshmive, (kriminalistika represive) si dhe me pengimin e vet kryerjes së veprave të ardhëshme penale (kriminalistika preventive).

Etiologjia kriminale ose faktorët mbi kriminalitetin kanë të bëjnë me njohjen e burimeve, rrënjëve dhe rethanave përcaktuese të kriminalitetit. Këto çështje i studijon dhe i analizon etiologjia kriminale, e cila deri më vonë është konsideruar si pjesë kryesore e kriminologjisë. Etiologjia kriminale analizon dhe studion lidhjet kauzale në mes të rrethanave e faktorëve të ndryshëm të kriminalitetit. Etiologjia merret me faktorët objektiv dhe subjektiv të cilët e kushtëzojnë fenomenin e kriminalitetit dhe dukurive tjera antisocial dhe negative në një shoqëri. Pra etiologjia kriminale angazhohet për shpjegimin dhe ndriçimin e rrugëve të cilat shpien deri te kriminaliteti.⁴⁵

3.2.1 Kryerësit e veprave penale kundër mjedisit dhe natyrës

Studimi i kryerësit të veprave penale ka qenë gjithmonë lëndë studimi nga ana e hulumtuesve dhe shkencëtarëve, mirëpo gjithmonë ka pasur mendime dhe rezultate të ndryshme rreth asaj se pse disa persona janë të prirur për të kryer vepra penale kurse disa të tjerë jo dhe kjo ka rezultuar me studimin e hollësishëm të personalitetit të njeriut, vetive psikike ose fizike të tij me qëllimin zbulimin e arsyes se çka e dërgon njeriun të bëjë vepra të kundërligjshme. Njeriu gjithmonë në histori është paraqitur si subjekt i veprës penale në mënyrë direkte apo edhe në atë indirekte dhe gjithmonë për të parandaluar krimin së pari hulumtuesit kanë analizuar dhe studiuar kryerësin e vepës penale. Mirëpo në mënyrë indirekte njeriu si drejtues i kompanive dhe drejtues i organizatave kriminale ka ngjallur interesim më të madh sepse ai nuk merret me krime të drejtpërdrejta ose nuk merr pjesë fare në krim, mirëpo ai urdhëron dhe shtyt kryerjen e tij, këto lloj kriminelash janë shumë njerëz të zakonshëm dhe në të shumtën e rasteve me reputacion në shoqëri dhe gëzojnë poste të larta nëpër institucione kurse motivet që i shtyjnë janë në të shumtën e rasteve ekonomike domethënë për pasurim, kurse ato në shoqëri njihen si njerëz të suksesshëm.

⁴⁵ Halili Ragip, "Kriminologjia", Prishtinë, 2011, fq 235

Ato veprimet e veta i drejtojnë në drejtim të thyerjes së rregullave dhe ligjeve me qëllim arritjen e suksesit kurse mundësia për tu përgjigjur penalisht është e vogël për shkak të aftësisë së tyre për t'i fshehur veprimet ose për t'i drejtuar në kahje të kundërta, si dhe bashkëpunimi dhe kryerja e favoreve me përgjegjësitë për ndjekjen e krimeve. Tek këto lloj njerëzish nuk mund të vërehet asnjë lloj sjellje kriminale, ato sillen normal në shoqëri duke punuar dhe duke qenë të dobishëm për familjen tek ato nuk mund të hasim ndonjë sjellje patologjike, ato janë njerëz të shoqërueshem familjar dhe me gjendje të mirë mendore për këtë shkak të provuarit dhe identifikimi i këtyre kryerësve është gati i pamundur.

Këto lloj persona rallë gjykohen mirëpo edhe kur gjykohen ato fshehen pas personave juridik si dhe marrin dënime me të holla dhe dënime të tjera të lehta përshembull rasti në Tëtovë me mbeturinat ku ndaj personit përgjegjës për këtë menaxhim me mbeturina është shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje prej tre muajve, dënime të cilat nuk do të zbatohen nëse të akuzuarit në afat prej 1 viti pas hyrjes në fuqi të aktvendimit nuk bëjnë vepra të reja penale. Këto dënime të lehta dhe jo serioze i motivojnë të tjerët që të kryejnë vepra penale kundër natyrës si dhe atyre që janë duke bërë të vazhdojnë me veprimtarinë kriminale.

3.2.2 Migrimet e popullsisë fshat-qytet

Migrimet (latinisht: migratio : shpërngulje) paraqet çdo ndërrim të vendbanimit të personave ose grupe të mëdha apo të vogla të njerëzve. Dallojmë dy lloje të migrameve:

1. Emigrimi - paraqet shkuarjen e popullsisë nga një vend i caktuar.

2. Imigrimi: ardhja e popullsisë nga një vend të caktuar.

Shkaqet e migrameve mund të jenë:

a) Natyrore - epidemitë, shkaqe atmosferike, katastrofa të ndryshme...

b) Shoqërore- luftërat, destabilizimi [politik, urrejtja fetare...

c) Ekonomike - uria, varfëria, lakmia për jetë më të lumtur...

Përshembull nëse bien sëmundje të ndryshme njerëzit janë të detyruar të ndërrojnë vendbanimet, shkaqet atmosferike janë kur përballen me rreshje të mëdha të shiut, siç është rasti

në vendet Indi, Bangladesh etj kurse sa i perket katastrofave natyrore si psh. termetet e ndryshme, cunamet, tornadot etj.

3.2.3 Mjedisi shoqëror

Pozita gjeografike e Maqedonisë është një faktor që në mënyra të ndryshme paraqet terren të përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve kriminale. Ndonëse nuk është vendi kyç që lidh vendet e lindjes dhe perëndimit Maqedonia gjendet në një pikë mjaft strategjike të Ballkanit Perëndimor ku shpesh herë shfrytëzohet nga grupet kriminale.

Sa i përket mjedisit jetësor në Republikën e Maqedonisë gjendja aktuale paraqitet mjaft shqetësuese, pasi që në vazhdimësi po bëhet një degradim në të gjitha resurset natyrore, si degradimi i shtretërve të lumenjëve nga nxjerrja ilegale e zhavorrit, si dhe prerja ilegale dhe shkatërrimi i pyjeve.

Pamja fizike e ambientit si faktor kriminologjen ka filluar që herët të studiohet nga autorë të ndryshëm, të metat e ambientit identifikoheshin si shkaqe nxitëse të sjelljeve kriminale. Arkitekti amerikan Oscar Newman (1972), me profesion arkitekt, kishte paraqitur në librin e tij "Hapësira mbrojtëse" teorinë që karakteristikat fizike të ndonjë zone mund të sugjerojnë banorëve dhe kriminelëve potencial që ajo zone është e ruajtur dhe e mbrojtur mire ose është e hapur për aktivitete kriminale. Teoria argumenton se një zonë është më e sigurtë kur njerëzit ndjejnë një ndjenjë të pronësisë dhe përgjegjësisë për atë pjesë të një komuniteti. Newman pohon se "kriminelit është i izoluar" kur një hapsirë është e mbrojtur mirë.

Sipas Newman ekzistojnë disa faktorë që krijojnë një hapësirë mbrojtëse:

- Territorialiteti - ideja se prona e dikujt është e paprekshme.
- Vëzhgimi natyror - lidhja midis karakteristikave fizike të një zone dhe aftësisë së banorëve për të parë se çfarë po ndodh
- Pamja - kapaciteti i dizajnit për të dhënë një ndjenjë sigurie
- Karakteristika të tjera që mund të ndikojnë në sigurinë, siç është afërsia me nënstacionin e policisë.

Nga këtu mund të nxjerrim se kriminaliteti ka gjasa të zhvillohet më shumë në ato vendbanime ku institucionet mbrojtëse dhe banorët e atij komuniteti që bashkëjetojnë në atë hapësirë nuk kujdesen për vendbanimet e tyre, kurse tek kriminelët nxitë ndjenjën që ajo hapësirë nuk është e mbrojtur dhe nuk i takon askuj, kështu që më lehtë mund të kryejnë aktivitete kriminale.

Revista e njohur “Societies” ka publikuar një studim shkecor ku thotë se nëse një fëmijë shfaq shenja agresiviteti, është i dhunshëm dhe nuk shoqërohet me të tjerët, përveç faktorëve familjarë dhe stresit, një rol të rëndësishëm luan edhe mjedisi shoqëror në të cilin rritet. Studimi që ka vëzhguar 1293 familje, nga nëntë vende si Kina, Kolumbia, Italia, Jordania, Kenia, Filipinet, Suedia, Tajlanda dhe SHBA-ja, tregon se fëmijët shfaqin sjellje agresive nëse jetojnë në një lagje të rrezikshme.

Duke pasur parasysh se personaliteti i fëmijës ndërtohet nga familja dhe rrethi ku jeton dhe rritet, ai observon të gjitha ato që ja ofron jeta në atë ambient, ai mund të merr sjelljet negative po aq sa edhe ato pozitive, kurse ka shumë mundësi nëse fëmija rritet në një ambient ku mungon përkujdesi dhe mbrojtja ai në të ardhmen të merret me sjellje kriminale.

Duke u përkujdesur për mjedisin shoqëror ne u japim mësim gjeneratave të ardhëshme se vendin të cilin jetojmë duhet ta rruajmë dhe ta mirëmbajmë dhe jo ta shkatrojmë, vetëm në atë mënyrë mund të ndërtojmë një vend cilësor dhe një gjeneratë e të ardhme më të mirë duke e konsideruar vendbanimin si të shenjtë.

3.2.4 Kushtet e vështira ekonomike sociale

Sipas mendimit të disa kriminologëve, ndikim më të madh në paraqitjen e kriminalitetit e kanë faktorët e jashtëm kriminologjen, ato ndikojnë drejtëpërdrejt në paraqitjen e aktiviteteve kriminale në shoqëri. Sipas disa studimeve bashkëkohore kriminaliteti në vendet e pasura ekonomiksht tregon ulje kurse në ato vende me kriza ekonomike tregonë një rritje.

Shkalla e ulët e zhvillimit ekonomik e përcjellë me nivelin e lartë të papunësisë dhe një numër të lartë të punëkërkuesve që arrinë shifrën prej rreth 25 % të personave të aftë për punë,

mund të ndikojnë drejtpërdrejt në situatën e sigurisë në vend, por edhe të zhvillimit të kriminalitetit.

Kjo gjendje e rëndë ekonomike e shumicës së qytetarëve të vendit mund të ndikojë që disa persona të fillojnë të merren me aktivitete kriminale për të përfituar para në mënyrë të shpejtë. Kjo nuk do të thotë që të gjithë të papunët kyçen në aktivitet kriminale por kjo situatë shfrytëzohet nga grupet kriminale për të rekrutuar anëtarë të rinj në aktivitetet kriminale duke i joshur me premtime se do të bëhen të pasur për një kohë të shkurtë. Grupet kriminale gjenden e rëndë ekonomike të qytetarëve të vendit (kryesisht të moshave të reja të papunëve dhe me nivel të ulët të arsimit) e shfrytëzojnë duke i inkuadruar në aktivitete kriminale si kurier të lëndëve narkotike, trafikim me qenie njerëzore, lëmoshë kërkues dhe vepra tjera. Gjendja ekonomike në Republikën e Maqedonisë është e ndërlidhur direkt edhe me gjendjen sociale. Maqedonia llogaritet në mesin e vendeve me një zhvillim të ulët ekonomik ku një numër jo i vogël i qytetarëve jetojnë në kushte të vështira ekonomike dhe sociale, kjo gjendje është e karakterizuar me numër të madh të papunëve, me mungesë të ligjit për sigurime shëndetësore, të ardhura sociale minimale, çmime të larta dhe shërbimeve publike, pagat e ulëta sidomos në sektorin privat, kualiteti i arsimit në nivelin jo të kënaqshëm dhe jo drejtuar sipas kërkesave të tregut të punës etj. Shkalla e arsimit mund të merret si faktorë lehtësues për zhvillimin e krimit nga fakti që tek niveli i mesëm, i ulët dhe atyre gjysmë analfabet niveli i njohurive për dëmet që shkaktohen nga aktiviteti i krimit është mjaft i ulët, për të mos thënë që nuk kanë njohuri fare.

Në shumicën e rasteve të krimeve ekonomike motiv kryesor është përfitimi material në mënyrë të jashtëligjshme. Pamundësia e qytetarëve që të ngrohen gjatë sezonës së dimrit me energji elektrike ose gaz shtynë ato që të ngrohen me drunjë, ku gjatë djegies së tij lirohen gazra ndotës si dhe stimulon aktivitetin e prerjes së jashtëligjshme të pyjeve.

KAPITULLI I KATËRT

FORMAT E LUFTIMIT DHE MASAT PËR PARANDALIMIN DHE SANKSIONIMIN E KRYERËSVE TË KRIMINALITETIT KUNDËR AMBIENTIT

4.1 Metodat më efikase në parandalimin e krimit ekologjik

Parandalimi i krimit ekologjik është shpallur me ligj si një nga parimet kryesore të mbrojtjes së mjedisit, i cili shtron kërkesat për mbrojtjen e mjedisit në një fazë të herëshme të zhvillimit të çdo veprimtarie. Padyshim që në parandalimin e krimit ekologjik përfshihen shumë organe shtetërore, shumë persona fizik dhe juridik qoftë ata të jenë vendas apo të huaj, të gjithë mbrojnë mjedisin por pa dalur jashtë ligjit “Për mbrojtje të mjedisit”.

Mirëpo, vlen të theksohet se rolin kryesor në parandalimin e krimit ekologjik padyshim se e ka Ministria e Mjedisit, ajo ka për detyrë të përgatit strategji dhe plane mjedisore, si dhe të vlerësojë dhe miratojë planet apo programet me pasoja negative të rëndësishme në mjedis. Poashtu kjo minisri ka rol të rëndësishëm në nxitjen dhe mbështetjen e veprimtarive që synojnë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, me ndihmën e instrumenteve dhe mjeteve të politikës së mbrojtjes së mjedisit të cilat janë të parashikuara me ligj.

Reduktimi i trafikut nëpërmjet nxitjes së çiklizmit apo ecjes në qytet.

Viteve të fundit është përmendur ngrohja globale dhe si shkaktar kryesor është rrallimi i shtresës së ozonit. Disa nga gazrat të cilat sjellin pasoja janë: dioksidi i karbonit, metani dhe klorofluokarburet. Mirëpo sasia më e madhe e lëshuar në natyrë është e dioksidit të karbonit i cili është edhe shkakëtar kryesor i ngrohjes globale. Ky dioksid i karbonit lëshohet nga: fabrikat, nga djegiet në natyrë dhe sasia më e madhe e tij lirohet nga përdorimi i mbeturinave.

Të krijosh një qytet më tërheqës për këmbësorë apo çiklistë është mënyra më e mirë që të ulët përdorimi i automjeteve. Frika në rrugë është një shqetësim shumë i madh dhe arsyeja kryesore që shumë qytetarë nuk pedalojnë. Më shumë se 60% e britanikëve thonë që do

pedalonin çdo ditë nëse ndiheshin të sigurt. Në pesë qytete të SHBA-së, ku praktika e përgjithshme është që pjesa kryesore e rrugëve të kenë hapësirë dhe infrastrukturë të veçantë për çiklistët, u vu re një rritje e menjëhershme prej 171% e përdorimit të biçikletave dhe një përgjysmim i numrit të aksidenteve.

Edhe ecja në qytet është një alternativë e riformimit të qyteteve moderne, e mbështetur me masa që kjo ecje të jetë efiçente, e këndshme, e sigurt. Ndër masat e zbatuara: zgjerim trotuaresh, vendosja e regjimit pedonal në rrugë e bulevarde, riadministrim i kryqëzimeve për dhënie të përparësisë të këmbësori. Kështu ulen ndotjet dhe rritet ai që Charles Montgomeri emërton Indeksi i Kënaqësisë të një Qyteti.

Zvogëlimi i ndotjes nga automjetet nëpërmjet zonave me akses të kufizuar.

Përqendrimi i shumë automjeteve në zemër të qytetit e përkeqëson shumë shpejtë cilësinë e ajrit. Zonat me akses të kufizuar për makinat kanë rezultuar mjaft të suksesshëm në reduktimin e trafikut dhe uljen e ndotjes. Për shembull Londra e cila ka vendosur taksë ekstra për lëvizjen në zemër të qytetit e ka ulur ndjeshëm trafikun që nga zbatimi i kësaj mase shtrënguese. Nga ana tjetër organizata për “Ajër të Pastër” në Londër, deklaroi se në 2010 Londra kishte nivelin më të lartë të CO₂ se çdo kryeqytet tjetër në Evropë.

Kjo mospërputhje vjen për faktin se taksa e lëvizjes në qendër arriti të eliminonte vetëm një pjesë të makinave, përgjithësisht shoferët me të ardhura më të ulta, por jo ata që kanë mundësi të paguajnë, taksitë dhe shërbimet e transportit të mallrave të ndryshme. Përqendrimi i një numri të madh mjeteve motorike në një zonë të caktuar rezulton fatal për shëndetin e qytetarëve. Së fundmi në 2012 u vërtetua se emetimet e dioksidit të nitrogjenit janë shkaku kryesor i sëmundjeve kancerogjene në popullatën e qyteteve të mëdha.

Disa qytete kanë pasur më shumë sukses në uljen e ndotjes së ajrit përmes zbatimit të zonave të kufizuara se sa të tjera. Për shembull Bolonja në Itali, është rasti më i suksesshëm. Trafiku u reduktua nga 23% deri 31% (në varësi të kohës dhe të ditës), por dhe emetimet e PM₁₀ u reduktuan me 47%. Për këtë arritje Bolonja fitoi dhe çmimin e “Lëvizshmërisë Europiane” në 2011.

Vendosja e një industrie që respekton cilësinë e ajrit

Një industri e pastër ndërtimi është një faktor kyç në përmirësimin e ajrit të qytetit, qoftë në aspektin e efikasitetit energjetic të ndërtesave si dhe në atë të ndërtimit të godinave. Ndërkohë që ndërtimi dhe rrëzimi i godinave krijojnë impakt të keq në cilësi të ajrit nëpërmjet lëshimit të pluhurave, duhet vendos një standart në monitorimin e cilësisë. Dhe kjo duhet të shoqërohet me fokusim për ndërtimin e godinave e efikasitet të lartë energjetic.

Shembuj qytetesh me masa të forta kanë nisur që në vitin 1990 kur Manila ndaloi me ligj ndërtimin e furnaltave, dhe Freiburgut në Gjermani ku është adaptuar legjislacion për minimizim e konsumit energjetic në godinat e reja. Ujërat e shiut pastrohen e ripërdoren për pastrim rrugësh, tallashi i mbetur nga industria ripërdoret për ngrohje. Çdo shtëpi ka një mini-përpunues mbetjesh nga ku prodhohet biogaz që përdoret për ngrohje dhe gatim.

Ndërtimi i rrugëve

Ndërtimi i rrugëve është parë historikisht nga qytetet si zgjidhje për të ulur nivelet e trafikur dhe për të rritur kapacitetin. Dhe si çdo ndodhi që mbështetet në traditë, shpesh ky proces tejkalon vlefshmërinë e tij në kohë. Ska shumë kohë që kryebashkiaku i Londrës shpalli idenë e krijimi të shtigjeve nëntokësore duke thënë se “lirohen hapësira në rrugët mbitokësore për këmbësorët, çiklistët dhe parqet publike. Si ide, ngjan e bukur. Por çdo studim në vëndet që kanë rritur kapacitetin e tyre rrugor në këtë mënyrë, ka treguar që impakti në cilësi të ajrit ka qenë gjithmonë negativ. Më shumë rrugë, do të thotë më shumë makina në qarkullim dhe kjo automatikisht sjell përqindje më të larta të gazrave dëmtoes në atmosferën e një syprine qyteti të çfarëdoshëm. Rezultat ky diametralisht i kundërt nga pretendimi fillestar i këtyre skemave.

Prova të përmirësimit të trafikut jepen dhe në raporte të ndryshme që hartohen mbi qytete me rrjet rrugor miks dhe dendësi të lartë banimi. Pra, sa më shumë lloje përdoruesish të akomodojë një rrugë (automjete, transpot publik, biçikleta, këmbësorë) aq më shumë rritet mundësia që banorët e zonës të zgjedhin diçka ndryshe nga autovetura.

Modifikimi i automjeteve të vjetra ndotëse.

Sot, automjetet projektohen për të punuar me fuqi hibride por shumica dërrmuese e automjeteve që qarkullojnë në rrugët tona janë të vjetra dhe mjaft ndotëse. Një ndër zgjidhjet që preferohet gjërësisht është përshtatja e automjeteve të vjetra me filtra pastrues për uljen e gazrave ndotës që lëshohen. Shqetësimi më i madh vjen nga motorat dizel të gjeneratave të kaluara. Ata kanë impakt shtatë herë më të madhë se ndikimi i kombinuar i 181 agjentëve ndotës të gjurmuar nga Agjencia e Mbrojtjes në SHBA. Po bëhen investime në këtë fushë dhe nëse mendohet si shpenzim i madh si për rastin e SHBA ku qarkullojnë mbi 11 milion automjete në të cilat masa duhen marrë, përlllogaritjet që për çdo dollar të shpenzuar në këto teknologji, 12 dollarë kursehen në monetarizimin e dëmeve shëndetësore.⁴⁶

Por nuk janë vetëm motorat dizel. Shumë triçikla në qytete aziatike operojnë me motora 2-kohësh që shkarkojnë gaze 13 herë më dëmtoese se motora të tjerë. Edhe pse është tentuar që këto të zëvendësohen me modele më moderne, thjeshtësia e tyre mekanike si dhe kostoja e ulët e mirëmbajtjes mekanike i bën ato akoma alternativa të tërheqshme.

Modifikimi i këtyre mjeteve apo edhe zëvendësimi i tyre me më të pastërta, është një nevojë imediate pasi do lejojë një frymëmarrje në vënde ku përdorimi i tyre kap masat dominante në transport, si Azia, India dhe Filipinet.

Si shembull mund të përmendim Moldavinë e cila për të mos e ndotur ambientin dhe për të mos e kthyer vendin në varreza të automjeteve ka miratuar ligjin i cili ndalon regjistrimin e automjeteve që kanë 8 vjetë që janë prodhuar.

Mirëpo nëse kthehemi dhe e shohim gjendjen e vendit tonë, realisht është e kundërta, vendi jonë është përplot me varreza makinash, dhe shumë të tjera që nuk janë më për standartin e Evropës përfundojnë në teritorin e vendit tonë. Mirëpo edhe gjithë kjo situatë ka një sqarim, duke ditur se vendi jonë është një vend i varfër, e duke e ditur se veturat më të vjetra kanë edhe kosto më të ulët, me automatizëm e kuptojmë se pse vendi jonë i ka gllabëruar makinat që janë jashtë standartit për Evropën. Ndërsa dogana për makinat e reja ka një kosto shumë më të lartë e që shumica e qytetarëve nuk i kan ëkushtet për të bërë një blerje të tillë.

⁴⁶ <https://ecovolis.wordpress.com/2015/04/03/6-masa-urgjente-per-te-ulur-ndotjen-e-ajrit/>

Zonat e gjelbërta

Ruajtja dhe zgjerimi i hapësirave të gjelbërta megjithëse e domosdoshme nuk mund të funksionojë e izoluar pa veprimet e mësipërme. Gjelbërimi rrit cilësinë e ajrit dhe ndihmon që hapësirat urbane të prodhojnë vetë një pjesë të oksigjenit. Kurora e gjelbërt rreth qytetit është gjithashtu jetike për banorët. Me pak fjalë gjelbërimi në zonat urbane nuk lidhet vetëm me vetëm me shëndetin fizik të njeriut, pasi paraqet burrim kryesor të pastrimit të ajrit, por ka edhe efektet psikologjike ndaj qytetarëve.

Një nga funksionet më të rëndësishme të gjelbërimit në qytete është edhe reduktimi i efektit të ngrohjes nga betoni dhe asfalti, të cilat thithin rrezatimin dhe lëshojnë nxehtësi. Bimët thithin rrezatimin e dëmshëm, lëshojnë avull dhe kanë efekt freskues që zbut efektin serë në qendrat e qyteteve.⁴⁷

Tetova qytet i dy universiteteve me trafik të dominuar me automjete, ku një pjesë e tyre janë të vjetra dhe ndotin më shumë ambientin. Ka patur iniciativa në mbjelljen e drunjëve në pjesët ku ndahen dy rrugët, por që kryesisht qyteti jonë është jomjaftueshëm i gjelbëruar. Në pjesën qendrore të qytetit plani urbanistik është shumë i ngjeshur, shtëpitë janë shumë afër njera tjetrës sa që nuk ka hapësira për zona të gjelbërta, po ashtu vërehen edhe një numër i madh i ndërtesave të larta të cilat po sjellin vetëm efekte negative. Në këtë aspekt duhen ndërmerren masa, vërejmë se ka shpërngulje të madhe të popullatës nëpër qytet, andaj të krijohet strategji që vetë qyteti të zmadhohet në gjerësi jo në lartësi. Këtë e themi se nëse qyteti zgjerohet në gjerësi do ketë hapësirë për gjelbërim.

Shumë studime të realizuara japin konkluzionin se mjediset cilësore domethënë të pastërta për nga efekti i ndotjes ndikojnë pozitivisht dhe ju risin vlerën pronave në afërsi të tyre. Gjelbërimi po ashtu ndikon pozitivisht edhe nëse aty afër gjendet një qendër tregtare, pasi tek blerësi përçohet ndjenja e respektit dhe përkujdesjes nga ana e shitësve, dhe e gjithë kjo shpije në frekuentimin më të shpeshtë dhe probabilitetin për të blerë mallrat e tyre.

Në qytet hapësirat e gjelbërta kanë një shumëllojshmëri funksionesh si: oksidimin, hijëzimin, kënaqësinë estetike, rregullimi i regjimit të ujrave, kapja e dioksidit të karbonit. Gjelbërimi i atribuohet efektit të “purifikimit” i ajrit nga ndotësit atmosferik.

⁴⁷ <https://ecovolis.wordpress.com/2015/04/03/6-masa-urgjente-per-te-ulur-ndotjen-e-ajrit/>

Problemi i cilësisë së ajrit është një nga temat shumë aktuale të qytetit tonë, kohën para mbylljes së ndotësit kryesor u mbajtën shumë protesta. Krahas mbylles së ndotësve kryesorë vendi jonë por edhe shumë vende tjera duhet që të realizojnë fushata të shoqëruara me aksione konkrete për shtimin e hapësirave të gjelbërta dhe pyllëzimin e zonave urbane. Këtë duhet realizuar pasi nga studimet e realizuar është ardhur në përfundim se në qytetet e mëdha hapësirat e gjelbërta ndikojnë në largimin deri më 100 % të grimcave PM10 dhe të shumë gazrave tjerë. Prandaj duhet të investohet në gjelbërim pasi është njeri prej faktorëve kryesorë të pastrimit të ajrit.

Ndarja e mbeturinave

Rritja e popullsisë më tepër vërehet në qytetet kryesore dhe padyshim se kjo rritje shpie edhe në rritjen e konsumit, e me këtë kuptohet edhe me rritje e pashmangëshme të mbeturinave. Padyshim që kjo shpie në një problematik të madhe dhe shumë të vështirë për të arritur një zgjedhje. Direktivat e Bashkimit Evropian janë vënë në zbatim në shtetet e Evropës në mënyra të ndryshme sai përket kësaj çështje. Vlen të përmendet shteti i Danimarkës i cili detyron përdorimin e ambalazheve të ripërdorëshme, dhe rikthimi tek shitësi i mallit.

Me pak fjalë problemi me mbeturinat duhet luftuar në shumë forma, dhe qëllimi kryesor është që sa më pak të digjen. Pasi djegia e mbeturinave mund të shkaktoj rrëzim të jetës së popullatës, e po ashtu me procesin e diegies përsëri mbeturinat nuk shkatërohen plotësisht, por që më e keqja është dhe hiri i mbetur përmban toksina të shumtë. Këto toksina mund të shpërndahen me ndihmën e errës në ajër, ose hiri me ndihmën e shirave depërton në tokë, e me këtë helmohet toka, pastaj këto lëndë helmuese mund të futen në zinxhirin ushqimor. Tani nga kjo informatë e fituar le të mendojmë se sa mbeturina po ndizen në vendin tonë, i shohëm nëpër amvisëri, por që është me e keqja këtë vit u dogj edhe vendi ku grumbullohen mbeturinat në Tetovë, le të mendojmë se sa substanca helmuese janë shpërndarë në ajër dhe sa janë futur në tokë me ndihmën e shiut që pati kohëve të fundit. Statistikat po ashtu janë alarmante për rastet e kancerit në rajonin tonë, për të mos e tepruar çdo i katërti person diagnostifikohet me kancer.

Padyshim se mbeturinat paraqesin një problem të madh, por mënyra se si mund ne të bëjmë zgjedhjen duke mos patur shumë shpenzime është që vetë banorët t'i klasifikojnë mbeturinat që në shtëpi. Klasifikimi i mbeturinave bëhet në atë formë që veçohen nga njëra tjetra mbeturinat biologjike të qelqit dhe të letrës, të metaleve etj. Pra qytetarët kanë për obligim të

klasifikojnë mbeturinat shtëpiake, por gjithashtu edhe komuna ka për obligim që të siguroj vende të posaçme ku do i hudhin këto mbeturina.

Kjo formë e klasifikimit është shumë hetuese dhe normalisht ka shumë mundësi në mbrojtjen e ambientit, pasi mbeturinat biologjike zakonisht hudhen në gropa të mëdha në tokë dhe me kalimin e kohës ato shndërohen në pleh dhe mund të përdoren në bujqësi. Nëse flasim për qelqin është material i cili mund ripërdoret, vetëm duke e pastruar dhe mund të përdoret përsëri, ose një variant tjetër është mund të dërgohet në punishte të bluhet dhe të shkrihet dhe përsëri riformohet amballazhi i ri. Gjithashtu edhe letra mund që të reciklohet dhe përsëri të përdoret. Plastika paraqet një prej materialet të cilat janë shumë praktike si amballazh, mirëpo duhet patur parasysh se të njejtat gjatë diegies lirojnë sasi të madhe të dioksidkarbonit. Andaj në këtë çështje mund të intervenojë dogana e shtetit, në atë formë që të bëjë ndalesë të të gjitha mallrave me amballazh që përmbajnë PVC, pasi këto janë të rrezikshme në diegje dhe lëshojnë sasi të madhe të dioksidit, ndërsa amballazhat e plastikës që janë të riciklueshme janë edhe më dobishme për vendin⁴⁸.

Padyshim se kjo çështje e lartëpërmendur është shumë e vështirë për tu realizuar, sado që të jenë të kujdeshëm qytetarët në ndarjen dhe kategorizimin e mbeturinave, gjithçka do jetë e kotë nëse vet komuna nuk i ndihmon dhe lehtëson qytetarët. Me fljalë tjera të gjithë së bashku nëse kontribojmë do parandalojmë krimin ekologjik e me këtë do ruajmë edhe shëndetin tonë.

Përdorimi i biçikletave si mjete udhëtimi

Tashmë e kemi të njohur se përdorimi i makinave si mjet transporti është i kushtueshëm si për blerje ashtu dhe për mirëmbajtje dhe njëkohësisht është edhe shumë ndotës pasi lëshon sasi të madhe të dioksidit të karbonit. Andaj duke i ditur këto informacione në vendin tonë duhet që të përpilohen plane që realizimin e kushteve e cila është e dobishme edhe për qytetarët por edhe për ambientin.

Zhvillimi i çiklizmit nëpër qytet mund të arrihet nëse:

- Informimi i qytetarëve mbi rëndësinë e përdorimit të biçikletave dhe mundësinë e zvoglimit të ndotjes së ambientit,

⁴⁸ Gurbardhi, A, “Sfidat ekologjike dhe krimi në fushën e ambientit”, Gazeta “Metropol”, 2005

➤ Informimi i qytetarëve se çiklizmi nuk tregon varfëri, mund të marrim shembullin e shtetit të Danimarkës, të gjithë e dimë se është ndër shtetet me ekonomi relativisht të mirë dhe në këtë vend rreth 30 % e transportit realizohet me anë të biçikletës,

➤ Shumë e rëndësishme është edhe krijimi i kushteve për qarkullimin e biçikletave, pa dyshim se formimi i këtyre kushteve nuk ka kosto edhe shumë të lartë, por lenja e një hapësire në mes rrugës.

Formimi kushteve për përdorimin e biçikletave nuk ka shpenzime të shumta, por vetëm parashikimi i hapsirës mes rrugës dhe trotuarit për këmbësorët me gjërësi 1.2 deri 1.5. Formimi i këtyre kushteve mundëson qarkullimin pa pengesa të këtij mjeti udhëtimi i cili është shumë më pak i kushtueshëm si në blerje ashtu edhe në mirëmbajtje se sa makinat tjera. Po ashtu vlen të theksohet se ky mjet transporti nuk kërkon përdorimin e karburantëve e cila padyshim ndot ambientin dhe po ashtu ky mjet është edhe i dobishëm për shëndetin e vetë atij që e përdor⁴⁹.

Furnizimi i transportit jondotës

Në arritjen e furnizimit të mjeteve transportit jondotës vetë shtetit i kushton shumë, pasi kërkon autobuza të prodhimeve të fundit të cilat posedojnë filtra, paisja me trena elektronik të cilat kanë kosto të lartë pasi ata kërkojnë formimin e shinave nëpër rrugë. Edhe pse janë shumë të kushtueshme dhe kërkojnë shumë investim nga ana e vetë shtetit, por nga ana tjetër janë zgjedhje afatgjate të cilat padyshim se e mbronë vendin nga ndotja. Në vendet evropiane investohet në transportin jo ndotës, por në vendin tonë ende nuk ka arritur ky inovacion i cili është mjaft i dobishëm për të gjithë qytetarët.

⁴⁹ Gurbardhi, A, "Sfidat ekologjike dhe krimi ne fushën e ambientit", Gazeta "Metropol", 2005

4.2 Masat parandaluese ndaj veprave penale kundër mjedisit

Mbrojtja efektive juridike penale e mjedisit, siç është detyrë tjetër e legjislacionit penalit, mund të realizohet vetëm nëse mbrojtja e mjedisit nga veprat penale që drejtohen kundër tij shoqërohen edhe me parandalimin e këtyre krimeve.

Si masë kryesore e parandalimit të krimit ekologjik është vetë politika e dënimit të kriminelëve ekologjik që bazohet në ligj, edhe metodat tjera parandaluese janë të dobishme dhe shumë të rëndësishme në parandalimin e kriminalitetit mjedisor.

Në Konventën e BE-së theksohet se për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet të drejtës penale (1998), parandalimi i dëmtimit të mjedisit duhet të arrihet edhe me anë të masave tjera jopenale⁵⁰.

Parimi i parandalimit është shpallur me ligj si një nga parimet kryesore të mbrojtjes së mjedisit, i cili shton kërkesën për marrjen e masave për mbrojtjen e mjedisit në fazë të herëshme të fillimit të veprimit kriminal⁵¹

Në marrjen e këtyre masave parandaluese janë përfshirë shumë njerëz dhe institucione si: organet shtetërore (përfshirë këtu policët, gjykatat), persona fizik dhe juridik, vendas dhe të huaj të cilët jetojnë dhe ushtrojnë detyra në këtë vend, dhe sipas ligjit për “ Mbrojtje të mjedisit” kanë për obligim që të mbrojnë vendin nga ndotja dhe dëmtimet.

Mirëpo për të realizuar obligimet ligjore e rëndësishme është parimi i përgjegjshmërisë së ndërsjelltë dhe bashkëpunim efikas në mes autoriteteve publike dhe personave fizik dhe juridik, pasi vetëm në këtë formë mund të synojmë në arritjen e objektivave për mbrojtjen e mjedisit.

Rëndësi të veçantë në aspektin e parandalimit marrin institucionet shtetërore, të cilët kanë obligim që parandalojnë krimin që nga procesi i planifikimit.

⁵⁰ I Elezi V Hysi “ politika kriminale” vep.e cit

⁵¹Konventa e keshillit të Evropës “Mbi mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet të drejtës penale” Council of Europe ETC No.172, Strasbourg, 04.09.1998.

Rolin kryesor në parandalimin e krimit ekologjik e ka Ministria e Mjedisit Jetësorë dhe Planifikimit Hapsinorë, duke filluar që nga përgatitjet në mënyrë periodike të strategjive dhe planeve mjedisore e deri tek roli vendimtar që ka në procesin e vlerësimit strategjik mjedisorë, i cili i paraprinë procesit të miratimit të planeve apo programeve me pasoja të rëndësishme negative ndaj mjedisit. Po ashtu, e njëjta ministri ka një rol të rëndësishëm në nxitjen dhe mbështetjen e veprimtarive që synojnë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes përdorimit të mjeteve dhe të instrumenteve të politikës së mbrojtjes së mjedisit.

Në kuadër të parandalimit të përgjithshëm të krimit ekologjik si instrument i dobishëm janë edhe strategjitë mjedisore, veçanarisht ato ndërsektoriale, të shoqëruara me plane përkatëse të veprimit, duke qenë se këto dokumente politike të hartuara në mënyrë periodike përbejnë fillesat e reformave të nevojshme që mund të kenë një impakt të rëndësishëm edhe në parandalimin e përgjithshëm social për veprat penale kundër mjedisit.

Këto strategji nënsektoriale të themi se janë të rëndësishme për arsye se në të përcaktohen objektivat e politikave mjedisore në tërësi dhe në çdo sektor në veçanti. Poashtu këto strategji janë të shoqëruara me indikatorët përkatës, duke u bazuar në analizën e kushteve, problematikave aktuale, shkaqeve dhe faktorëve, si dhe sfidave që përballen sektori përkatës.

Reformat që realizohen në kuadër të mbrojtjes së mjedisit, padyshim se janë një hap shumë pozitiv dhe i dobishëm, dhe parandalimi shoqëror i krimit ka shumë përpasi në kuadër të politikës kriminale do ndikojë drejtpërdrejt në krimijimin e kushteve shoqërore, që do të mundësojnë zbatimin dhe implementimin efektiv të ligjit, si dhe parandalimin e shkeljeve ndaj mjedisit dhe realizimin e veprave penale kundër mjedisit.

Përkundër reformave ligjore dhe institucionale janë thelbësore për parandalimin e shkeljeve të ligjit, në mënyrë të domosdoshme kërkon investim të madh, por duke e ditur që në vendin tonë çdo herë ka deficit të buxhetit të ndërprerë për këtë ministri është i pamjaftueshëm dhe kjo realisht e pamundëson inspektorimin dhe ndëshkimin e të gjithë atyre të cilët bëjnë shkelje. Mirëpo e rëndësishme është që të dihet se këto reforma janë realizuar në kuadër të BE-së, atëherë më automatizëm shteti jonë mund të përdor instrumentin financiar IPA (Instrumenti i Asistencës së Para- Anëtarimit), i cili është fokusuar edhe në forcimin e institucioneve.

4.3 KRIMINALITETI DHE ORGANET E JUDIKATURËS

Secili shtet mbron ambientin e tij jetësor, disa shtete kanë ligje dhe nënligje më të rrepta dhe mbrojnë në mënyrë fanatike ambientin jetësor, dhe në rast të realizimit të ndonjë krimi edhe më të vogël ekologjik sanksionet janë shumë të mëdhaja, por ka shtete tjera ndër to është edhe shteti jonë edhe pse ka ligje më të cilat mbrohet ambienti jetësor, por nga ana tjetër shumë pak sanksionohen ata të cilët realizojnë një krim ekologjik. Kohëve të fundit mund themi se ka pasur disa ndryshime pozitive si p.sh. mbyllja e fabrikes “Jugohrom Ferroalloys” , për shkak se nuk i posedon filtrat dhe me këtë u helmonin qytetaret e rrethinës, gjithashtu u ndërmorën masa edhe ndaj atyre që po dëmtonin pyjet, pra prenin drunjë pa patur leje. Por nga ana tjetër nuk po zgjidhet problemi me deponitë e egra që po i shohim gjithandej.

Me këto shembuj doja të lidhem në atë se Legjislacioni i Republikës së Maqedonisë, duke u nisur që nga Kushtetuta, ligjet, aktet nënligjore, parashikon mbrojtjen e mjedisit jetësor. Një nga vlerat themelore të rendit kushtetues të R.Maqedonisë është edhe rregullimi dhe humanizimi i hapësirës dhe mbrojtja dhe përparimi i mjedisit jetësor dhe i natyrës⁵²

Republika e Maqedonisë, ka nënshkruar dhe ratifikuar një mori aktesh ndërkombëtare, të cilat janë bërë edhe pjesë e legjislacionit të brendshëm. Më pas (n.43) parashikon se: “Çdo njeri ka të drejtë në mjedis jetësor të shëndoshë. Secili është i obliguar që ta mbrojë dhe përparojë mjedisin jetësor dhe natyrën.Republika siguron kushte për realizimin e të drejtës të qytetarëve në mjedis jetësor të shëndoshë.”

Mënyra më e mirë për zgjidhjen e problemeve të lidhura me gjendjen e mjedisit jetësor, është krijimi i instrumenteve adekuate, krijimi i politikës, ligjeve dhe institucioneve për zgjidhjen e tyre në nivel global, nacional dhe lokal. Parim përgjithësisht i pranuar, është, nëse parandalimi nuk jep rezultat, problemi më së miri zgjidhet në vendin e paraqitjes së tij, kështu që duhet të mendojmë në aspekt global, por të veprojmë në aspekt lokal.Burimet juridike për mbrojtjen e mjedisit jetësor në nivel lokal në republikën e Maqedonisë, Vetëqeverisja lokale, si formë administrative e bashkësisë lokale, e ka për obligim të mbrojë dhe përparojë ambientin jetësor,

⁵² Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e v. 1991, neni 8

sepse ato janë çështje me interes për qytetarët, që të vendosin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pavarur.

Pasi këto çështje janë të lidhura me mbrojtjen dhe përparimin e ambientit jetësor në nivel lokal, kërkojnë edhe veprimtarinë në suaza të institucioneve lokale dhe organeve përfaqësuese. Në kompetencë të institucioneve lokale, si dhe të organeve përfaqësuese, është që të krijojnë kushte për udhëheqje të drejtpërdrejtë edhe me pjesët themelore të nënsistemit ekologjik. Mirëpo pushteti lokal për shkak të mungesës së kompetencave të vërteta, nuk ka përvojë të madhe në këtë fushë. Po ashtu është e nevojshme të bëhet bartja e kompetencave institucionale, në kontekst të decentralizimit, për mundësitë financiare, teknike dhe mundësitë tjera. Këtë të drejtë e parashikon edhe Ligji për vetëqeverisje lokale (n.22), ku si kompetencë lokale, është përcaktuar edhe mbrojtja e mjedisit dhe natyrës, nëpërmjet implementimit të masave për mbrojtje⁵³

Përveç legjislaturës për mjedisin jetësor në nivel nacional, me rëndësi të veçantë është përgatitja dhe aprovimi i Planit Ekologjik Aksional Lokal (shkurt PEAL). PEAL është projekt themelor për zhvillimin në nivel lokal, si dhe paraqet bazë për planifikim strategjik të nënsistemit ekologjik të zhvillimit të komunës.

Obligimet e komunës në lëminë e mjedisit jetësor, veç tjerash janë:

- Ngritja e nivelit të arsimimit dhe ndërgjegjes publike, për mbrojtje dhe përparim të ambientit jetësor,
- Sjellja dhe realizimi i Planit Ekologjik Aksional Lokal, (shkurt, PEAL), në përputhje me Planin Ekologjik Aksional Nacional (PEAN), për periudhë gjashtë vjeçare, si dhe ky plan të implementohet në përditshmëri. Planet ekologjike aksionale lokale, përmbajnë masa dhe aktivitete afat-mesme dhe afat-gjate për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe shëndetin e njerëzve, mes të tjerash edhe për:
 - Furnizimin e qytetarëve me ujë kualitativ për pije dhe mbrojtje të ujërave nga ndotja.
 - Pastrimin e ujërave të përdorura.

⁵³Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e v.1991, neni 87 Ligji për mjedisin jetësor 8 Doracak

- Ngritje të vetëdijes publike dhe zhvillim të arsimit për mbrojtje dhe përparim të mjedisit jetësor etj.
- Subjektet e autorizuara për realizimin e elementeve të veçanta të planit.
- Të jep mendime për projekte dhe të marrë pjesë në diskutime publike.
- Komuna duhet të përgatisë plan të jashtëm në rast të gjendjes të jashtëzakonshme.
- Komuna ka të drejtë të autorizojë inspektorë lokalë për ambient jetësor.
- Obligim i Komunës është edhe sjellja e Planit nacional për ujërat me bazë ekonomike, si dhe planet për udhëheqjen në trupat drejtuese të shtretërve të lumenjve. Pasi ujërat janë resurs i rëndësishëm dhe kalojnë nëpër territorin e më shumë komunave, angazhimi rreth tyre qëndron në bashkëpunimin dhe koordinimin e pushtetit shtetëror dhe strukturave komunale
- Obligimi i komunës është që të realizojë planet për mbrojtjen e ujërave lokale në territorin e tyre, si dhe realizimi i masave për ndotësit më të vegjël të ujërave.

Sipas Direktivës së Unionit Evropian për ujërat, Komunitat kanë të drejtë të formojnë trupa drejtues për shtretërit e lumenjve, përgjegjës për udhëheqjen me ujërat e rrjedhjes së plotë. Me rëndësi është edhe planifikimi hapësinor, (i projekteve ndërtimore të infrastrukturës dhe nevojës për lokacione adekuate), si dhe ndërtimi i stacioneve për pastrim të ujërave të përdorura dhe udhëheqja me to.

Në planet urbane hyjnë edhe propozimi dhe shpallja e zonave mbrojtëse ujore. Me ligje të veçanta nga lëmia e mjedisit jetësor, parashikohen edhe mundësi të tjera për iniciativë autentike në nivel lokal, si për shembull:

- Formimi i rrjeteve lokale për mbikqyrje të situatës së ambientit jetësor;
- Mbajtja e regjistrave për materialet dhe substancat ndotëse;
- Mbajtja e kadastrit për ambient jetësor, etj.
- Në nivel lokal është edhe propozimi për shpallje të rajonit të mbrojtur dhe pjesëmarrja në përgatitjen e planeve për udhëheqje me rajonin e mbrojtur.
- Në nivel lokal është edhe obligimi i mbrojtjes së: përmendoreve të natyrës, pyjeve-parqe; të zonave ujore, shtretërve të lumenjve, ujërave nëntokësore, etj.

Organet e judikatures në të cilën përfshihen prokuroria penale, gjykata penale dhe organet për ekzekutimin e sanksioneve penale. Të gjithë këto organe të juridiksionit kanë për obligim që të përcjellin dhe t'i analizojnë dukuritë, si dhe të japin propozimet e veta për pengimin e dukurive të rrezikshme shoqërore dhe të atyre që paraqesin shkelje ose rrezikim të të mirave ose të interesave përkatëse shoqërore. Kjo ka për qëllim forcimin e ligjshmërisë dhe të përgjegjësisë në shoqëri.

Në esencën me veprimet e organeve të juridiksionit është i mundur pengimi i shfaqjes krimogjene dhe ndërmarrja e masave në mënjanimin e shkaqeve të sjelljeve të ndryshme devijante.

Këto organe ndërmarrin shumë masa të pengimit por edhe të dënimit të shkelësve të ligjit në të cilën bëjnë pjesë: masat e dënimit me kusht dhe të vërejtjes gjyqësore, masat e sigurisë, masat edukative në aplikimin e të cilave insiston politika bashkëkohore kriminale, pikërisht për shkak të veprimit të tyre të mundshëm preventiv.

Masat represive të juridiksionit penale për një kohë të gjatë kanë qenë masa të vetme dhe ekskluzive, kurse tek në kohë të fundit rëndësi të veçantë kanë masat e caktuara, esenca e të cilave, edhe pse postdelikvente, para se gjithash është preventive.

Shumë legjislacione me aplikimin e këtyre masave kanë arritur rezultate të rëndësishme në kundërvënien ndaj kriminalitetit për ç'arsye legjislacionet moderne përpiqen që t'i aplikojnë në sistemet e veta ndëshkimore. Intenca e politikës kriminale qëndron në forcimin e rolit preventiv të këtyre organeve në mënyrë që kontributi i tyre në kundërvënien ndaj kriminalitetit të bëhet edhe më i rëndësishëm. Funkcioni represiv i atyre organeve, ndërkaq, në kuptimin kushtetues, ligjor dhe praktik është predominant në raport me atë preventiv, gjë që organet nuk i bënë mjaft efikase në plan të parandalimit.

Mirëpo vendet tona hasen në vështirsi në realizimin e masave ndaj krimit andaj është e preferuar që shteti të përdorë projektet që mundësohen nga BE-ja, pasi përfshirja në këto projekte mundëson marrjen e informacioneve dhe të eksperiencave nga vendet tjera. Me pak fjalë janë aktivtete mjaft të dobishme për vetë shtetin pasi fitohen eksperiencia të nga vende të ndryshme, por përsëri ngelet e rëndësishme që këto eksperiencia të zbatohen në praktikë edhe në vendet

tona.Me pak fjalë për nga natyra legjislacioni mjedisor është mjaft kompleks dhe dinamik andaj është shumë e dobishme që të përdoren trajnime, pasi sjellin shumë lehtësime.

Po ashtu, përgaditje e një stafi të kualifikuar dhe të mirëtrajnuar në vazhdimësi përfshirë këtu edhe zbatimin dhe implementimin e legjislacionin mjedisor është bazë e mirë për të zbatuar rekomandimet e Programit të Krimit Mjedor pranë Interpolit mbi krijimin e një rrjeti kombëtarë të bashkpunimit midis të gjithë agjencive përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit mjedisor, përfshirë policinë, doganat, prokurorinë, gjyqësorin dhe agjencitë mjedisore e cila mund të shërbejë si “pikë qendrore” edhe për operacionet dhe nismat me qasje rajonale dhe ndërkombëtare kundër krimit të organizuar mjedisor.

Po ashtu duhet të kemi të qartë se në vendin tonë Gjykata e Lartë mbi veprat penale kundër mjedisit është e kufizuar, në krahasim me shumë vende tjera që kanë një jurisprocedurë më të zhvilluar dhe të pasur në këtë drejtim. Mund të përmendim rastin e shtetit të Italisë i cili ka krijuar seksione të veçanta penale në Gjykatën e Lartë, të cilët merren në veçanti me interpretimin e të drejtës në fushën e veprave penale mjedisore.

Një gjë e tillë nuk është në vendin tonë andaj edhe Gjykata jonë haset në vështirësi në interpretimin e shumë rasteve të krimit ekologjik.Këto vështirësi mund të tejkalohen me ndihmën e përkufizimeve apo shtojcave ndihmëse të ligjit dhe mbështetje edhe më e madhe mund të arrihet duke u bazuar në juriprocedurën e Gjykatës Evropjane të Drejtësisë.

4.4 Roli i policisë në parandalimin e kriminalitetit ekologjik

Policia, si organizatë tipike shtetërore, ka një diapazon shumë të llojlojshëm të punëve që dallohen reciprokisht sipas metodave dhe formave të veprimit (Modly, 1997: fq. 518). Me kryerjen e punëve policore mund të arrihen qëllime të ndryshme që mund t’i ndajmë në dy grupe themelore:

- Pra, fjala është për punët me kryerjen e të cilave pengohen dhe zbulohen deliktet që në qarqet kriminalistike – operative, profesionale dhe shkencore i quajmë punë operative,

➤ Pastaj punët që kanë të bëjnë me aplikimin e drejtpërdrejtë të dispozitave, nxjerrjen e akteve administrative, ndërmarrjen e masave administrative, kryerjen e veprimeve administrative dhe të mbikëqyrjes administrative.

Inovacionet në parandalimin e kriminalitetit, që aplikohen gjatë disa viteve të fundit në vendet e zhvilluara të botës, mbështeten në një qasje krejtësisht të ndryshme të kryerjes së punëve policore. Ky inovacion kryesisht është përqëndruar në parandalimin e të gjitha situatave dhe të veprimeve që do të mund të merrnin përmasa të sjelljes kundërligjore.

Mirëpo për tu arritur parandalimi i krimit normalisht që policia e cila ka për obligim të mbroj qytetarët dhe ambientin, duke iu përmbajtur parimeve të caktuara në punë është parakusht për zbatimin e suksesshëm të masave të ndryshme të parandalimit.

Ndarja e përgjithshme e veprimit preventiv të policisë do të mund të fillonte me ujëndarësen midis parandalimit të drejtpërdrejtë, që ka të bëjë me të gjitha statet e procedurës penale, dhe parandalimin indirekt kriminalistik, që kufizohet në zbulimin, ndërprerjen e të gjitha situatave, të rrethanave dhe të gjendjeve që çojnë në rrezikimin e sigurisë publike, nëse nuk është e mundur të pengohen, atëherë të bëhen përpjekje që të mbahen nën kontroll.

Në aktivitetin preventiv të policisë ekzistojnë parime të caktuara të cilave ajo duhet tu përmbahet vazhdimisht në atë se duhet që në vazhdimësi ta njoftoj popullatën për krimet në përgjithësi por edhe të atyre të mjedisit. Kjo fushë e veprimtarisë së policies është mjaft delikate, por nga ana tjetër mjaft e suksesshme, pasi nëse informohen dhe njoftohen drejt popullata për krimet e mundëshme ato mund të jenë bashkëpunues me policinë dhe pikërisht ato mund të jenë ata të parët të cilët mund të japin informacionet fillestare për krimet e mundëshme në rajonin ku jetojnë.

Parandalimi i suksesshëm nënkupton kontaktimin e policisë me një numër të madh qytetarësh, në raport me popullatën e gjithëmbarshme të një vendi të caktuar. Tek policët ekziston tendenca që kryesisht të kontaktojnë me kriminelët, viktimat e kriminalitetit dhe pjesërisht me viktimat potenciale, kështu që pjesa më e madhe e popullsisë qëndrojnë anash në mënyrë pasive⁵⁴

⁵⁴Modly, Korajliq, 2002, fq. 494

Vullneti politik dhe institucional në parandalimin e krimit ekologjik

Krimi ekologjik paraqet një temë të mprehtë dhe shumë të diskutueshme në ditët tona. Paraqet formën më ekstreme të dëmtimit të mjedisit në mënyrë të qëllimshme.

Si faktor kryesor i krimit ekologjik është niveli ekonomik i ulët dhe varfëria të cilat janë ndikuesit e parë të këtij krimi, por në qoftë se nuk mbrohem nga krimi ekologjik mund të vijë që shoqëria të varfërohet ende më shumë dhe të humbtërisht resurset qëna ka dhuruar natyra.

Si formë e parë mbrojtëse që të mos vijë deri te ajo që përmendëm është legjislacioni dhe kuadri ligjorë është barrierë e parë e pengimit të krimit ekologjik, dhe falë asistencës ndërkombëtare të Bashkimit Evropian vendi ynë ka formuar një legjislacion bashkëkohorë në të cilin janë integruar çështje dhe masa të domosdoshme për parandalimin, kontrollimin apo ndëshkimin e krimit ekologjik.

Mirëpo nëse bëjmë një analizë për vendin tonë shohim se pyet po masakrohen në mënyrë barbare, mbeturinat po hidhen kudo, po digjen kudo, lumenjtë e vendit tonë janë në gjendje të mjerueshme, hidhen mjete ndertimi, mjete të amvisërisë, fabrikat nuk i përmbushin standartet për mbrojtje ndaj ndotjes.

Nga gjithë këto të dhëna mund të themi se ligji i miratuar nuk ka shumë rëndësi nëse qëndron në letër dhe nuk zbatohet, me rëndësi është që ky ligj i miratuar të zbatohet. Për zbatimin e tij padyshim se duhet të merren masa, dhe të kërkohet një angazhim shumë serioz jo vetëm nga ana e qeverisë por edhe nga ana e bizneseve dhe publikut të gjerë.

Zbatimi i ligjit për mbrojtje të ambientit jetësorë kërkon që ketë kontrolle inspektorimi dhe detyrime dhe vënien sanksioneve të shkelësve të ligjit apo dëmtuesve të ligjit përballë përgjegjësisë se shlyerjes së dëmit të shkaktuar në mjedis.

Në legjislacionin e BE-së kuadrin e masave dhe dënimeve për aktivitetet kriminale ndaj mjedisit e luan Direktiva “Për mbrojtjen e mjedisit përmes legjislacionit penal” e cila është e lidhur ngusht me rreth 70 direktiva, dhe në bashkpunim me këto direktiva sigurohet që regullat dhe kërkesat e parashtruara për mbrojtjen e ambientit të bëhen plotësisht efektive. Disa nga këto direktiva janë pjesë e legjislacionit të vendit tonë dhe pjesa tjetër do të miratohen në vitet në vijim.

Mirëpo ajo që haset në vendin tone është edhe vakumi ligjor lidhur me veprat penale mjedisore duke i konsideruar ato nga ana e prokurorisë dhe Gjykatave kompetente si kundërvajtje administrative. Ndryshimi dhe ndarja e qartë e shkeljeve administrative dhe penale do të mundësoj dhe garantoj një mbrojtje më të lartë të mjedisit natyrorë e më këtë do të mundësoj, forcoj zbatimin e ligjit.

Nëse në vendin tonë vendosen rregulla të njejta me ato të BE- së për shkeljet penale, do tëna mundësohet të përdorim edhe metoda efektive të hetimit dhe të trajtimit të këtyre rasteve njëllor si në vendet e BE-së. Po ashtu për një mbrojtje më të mirë të mjedisit kemi nevojë për dënime më të forta që dekurajojnë veprat e dëshme ndaj mjedisit, që shkaktojnë dëme të rënda në ujë ajër dhe tokë dhe në biodiversitetin. Andaj vendi jonë duhet të bëjë këto ndryshime dhe të jenë të njejta me të BE-së, pasi mbrojtja e mjedisit përmes legjislacionit penal do jenë shumë të dobishme dhe shumë e më shumë efektive.

Mirëpo tani një gjë të kemi të qartë masat parandaluese janë shumë më të dobishme se sa dënimi i atyre që tashmë kanë bërë krim ndaj mjedisit, andaj përpjekjet tona duhet të fokusohen në rend të parë mbi parandalimin e krimit ekologjik, përsëmbull bizneset që shkelin ligjin e mjedisit do të mbajnë përgjegjësi dhe do të mbulojnë koston e rehabilitimit të tij. Tek e fundit duhet të dinë që parandalimi kushton më pak se sa gjoba ose mbyllja e aktivitetit për shkak të një veprë penale.

Është e preferueshme që Ministria e Mjedisit të ketë bashkpunim me qytetarët, pasi bashkërisht mundësohet mbajtja e mjedisit të pastër e të shëndetshëm si dhe ndëshkimin e gjithë atyre të cilët tentojnë të dëmtojnë mjedisin.

Po ashtu është e favorshme që qeveria të aplikoj metodën e “tolerancës zero”, për çdo krim i cili realizohet, qoftë ai shkaktar i ndotjes së ajrit, ujit , tokës, gjuetisë, prerjen e paligjëshme të drunjëve, trajtim dhe menaxhim i paligjshëm i mbetjeve, menaxhim i kundërligjshëm i produkteve dhe substancave të rrezikëshme, dëmtim i specieve dhe i zonave të mbrojtura. Pra trajtimi i tillë ndaj atyre që e dëmtojnë cilësinë e jetës dhe mjedisit të vendit tonë duhet të jetë prioritet për Qeverinë dhe Ministrinë së Mjedisit jetosor dhe planifikimit hapësinorë.

Metodika e zbulimit të kriminalitetit ekologjik

Për të arritur deri tek zbulimi i krimit ekologjik padyshim duhet të kemi informatë se në atë hapësirë po realizohet një krim ekologjik dhe padyshim që duhet të ndërmerren masat adekuate. Si burim njohurish me se shpeshti paraqiten mjetet e informacionit, veprimtaria e organeve inspektuese dhe enteve perkatese, si dhe aktiviteti operativ i policisë.

Per kryerjen e veprave penale të kriminalitetit ekologjik mund të mësojmë edhe nga kallëzimet e qytetarëve që jetojnë në territorin e rrezikuar si dhe nga kallëzimet anonime dhe me pseudonime.

4.5 Politika e dënimit ose sanksionet kundër krimit mjedisor

Politika e dënimit paraqet një element mjaft të rëndësishëm në drejtim të sigurimit të një mbrojtje juridike penale sa më efektive të mjedisit e cila njëherit është edhe pjesë e pandarë e politikës kriminale kundër veprave penale mjedisore⁵⁵.

Shumë studime të realizuara kanë arritur në përfundim se dënimet e ulëta dhe llojet jo të përshtatëshme dhe të mjaftueshme të tyre mund të kthehen në shqetësim serioz në kuadër të luftës efektive ndaj krimit mjedisorë, pasi niveli shumë i ulët i dënimit mund që të vë në dyshim dhe vetë ekzistencën e efektit të tij parandalues, e në disa raste mund që të kthehet në një faktor kryesor në rritjen e kriminalitetit mjedisor. Me fjalë tjera niveli i ulët i dënimit ndihmon rritjen e kriminalitetit mjedisor.

Nga praktika gjyqësore në Gjykatën Themelore të Tetovës së fundmi e kemi rastin e gjykimit të drejtorit e ndërmarjes publike komunale të Tetovës, e ndjekur nga prokuroria themelore është konstatuar se në periudhën prej 20.05.2014 deri më 20.08.2014 ndërmarja publike NPK “TETOVA” me drejtor Xh.C. në mënyrë të pa hijshme gjatë menaxhimit me mbeturina ka shkaktuar rrezik ndaj të mirave dhe shëndetit të popullatës në kundërshtim me nenin 8 të “Ligjit për menaxhim me mbeturina” ,në mënyrë duke drejtuar me automjetet e mallrave të personit juridik ,ngarkuan dhe shkarkuan mbeturinat në kontejnerët e të gjithë zonës

⁵⁵ I.Elezi,V. Hysi, politika Kriminale, PEGI, Tiranë, 2006, f.101

së qytetit të Tetovës me një sasi ditore afërsisht 50 tonësh, pa autorizim nga organi kompetent kanë shkarkuar në parcelat e ashtuquajtura “stacion transferimi” e cila gjendet në afërsi prej vetëm 50 metra nga shtëpia e parë e qytetit dhe ngjithur me pikat e e furnizimit me ujë të pijshëm. Në këtë rast bëhet fjalë për deponi të egër e një lloji të hapur që nuk është e parashikuar me urbanizim me anë të se cilës kanë shkaktuar rreziqe për shëndetin publik dhe çënojnë të mirat dhe shëndetin e njerëzve, me këtë veprim ndërmarrja publike ka kryer veprë penale “Rrezikim I mjedisit jetësor dhe natyrës me mbeturina “ nga neni 230 dhe neni 45 i Kodit penal. Kurse gjykata vendisi dënime me kusht prej tre muajve për drejtorin e ndërmarrjes publike komunale të Tetovës, Xh.C si dhe 3200 euro gjobë me para për ndërmarrjen publike komunale Tetovë. Me vendimin e gjykatës së apelit, aktvendimi i shkallës së parë është ndryshuar në pjesën e sanksionit penal për personin juridik, Ndërmarrja publike komunale Tetovë, ndaj së cilës tani është shqiptuar dënim në para prej 200 mijë denarëve. Këtë dënim personi juridik është i detyruar ta paguajë në afat prej 30 ditëve pas pranimit të aktvendimit në fuqi. Në të kundërtën, dënimi i shqiptuar në para, do të realizohet me detyrim. Ndërsa për personin përgjegjës XH.C është shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje prej tre muajve, dënime të cilat nuk do të zbatohen nëse të akuzuarit në afat prej 1 viti pas hyrjes në fuqi të aktvendimit nuk bëjnë vepra të reja penale.

Për të qenë i suksesshëm dënimi ndaj këtij lloji krimi duhet që të ketë një qasje drejtë një skeme të përshkallëzuar të dënimeve të parashikuara për veprat penale kundër mjedisit, e përshtatur me shkallë të ndryshme të rrezikshmërisë së rrezikimit apo dëmtimit të shkaktuar nga secila veprë, mund të shërbejë më së miri për përmisimin e mjeteve që përdoren nga një shtet në përpjekjen e tij për mbrojtjen sa më efektive të mjedisit.

Padyshim se realizuesit e krimeve ekologjike duhet të marrin dënimin e merituar, pasi nëse shteti qeveria nuk ndërmerr asnjë hap në saksionimin ose dënimin e krimeleve të mjedisit, padyshim se ata nuk ndalen dhe vazhdojnë të bëjnë krime të kësaj natyre.

Në dënimin e krimeleve ekologjik ekzistojnë tri lloje të sanksioneve legale:

➤ Sankionet penale

- Sanksionet administrative,
- Sanksionet civile

Në mënyrë tipike, dënimi për një krim të ambientit është gjoba ose burgimi. Por që gjobat janë qasje tradicionale për dënimin e kryerësve të krimit ekologjik. Edhe ose janë bërë reforma në ligjin për mbrojtjen e ambientit, përsëri gjobat vazhdojnë të jenë në qendër të sanksioneve.

Që gjobat të jenë sa më efikase dhe sa më bindëse për realizuesit e krimeve ato sa vjen e rritet, e sidomos gjobat për ata individ të cilët vetëm se e përsërisin të njejtin krim.

Formë tjetër e sanksionimit të kryerësve të krimeve ekologjike është edhe burgimi përshembull në vendet si Australia individi i cili është shpallur fajtorë për ndotjen e ambientit mund të fitoj burg deri më 7 vjet. Kjo dukuri në vendet tona ende nuk praktikohet, zakonisht sanksionet janë me gjoba në para.

Përveç këtyre llojeve të dënimeve që përdoren ndaj kryerësve të krimeve ekologjike ekziston edhe një lloj tjetër i dënimit i cili quhet “dënim alternative”, i cili përdoret te kryerësit e veprave penale kundërt mjedisit përfshirë këtu; gjysëmlirinë, pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrim për kryerjen e një pune në interes publik, ndonse ky i fundit mund të jepet vetëm me pëlqimin e tij. Por, në këtë lloj të dënimit me rëndësi është vlerësim i kujdesëshëm dhe përshtatje e secilit lloj të dënimit alternativ me natyrën e veçantë të veprave penale kundër mjedisit, si përshembull në rastin e detyrimit për kryerjen e një pune në interes publik, mund të përzgjedhet një lloj pune e cila kontribon në mbrojtjen e mjedisit.

Në rast se një dëmtues i ambientit i shqiptohet një dënim alternative, rol të rëndësishëm në realizimin e këtij ka edhe gjykata. Gjykata është i vetmi institucion i cili mund të detyrojë të dënuarin që të plotësoj një ose disa nga detyrimet e parashikuara në ligj. Këto dënime mund të jenë të natyrës psh të detyroj të riparoj dëmin e shkaktuar, po ashtu mund të detyroj që mos e ushtroj veprimtarinë profesionale e cila lidhet me veprën penale të kryer kundër mjedisit.

Pra të gjithë këto sanksione që i përmendëm më lartë realizohen në rast të krimit ndaj mjedisit, dhe të cilat nëse realizohen në përputhje me vlerën e krimit të realizuar normalisht se do jenë mjaft efektive.

KONKLUZIONET

Një ndër masat e para që duhet të ndërmarrë nga orgabet shtetërore me shpejtësi është gjetja e mundësive që ngrohja në shtëpi të mos bëhet me energji elektrike ose me djegie fosile por të mundësohet sistemi i ngrohjes me burim të përbashkët në mënyrë që të kursen energji elektrike si dhe të rralloj burimet natyrore. Qeveria e shtetit duhet të financojë promovimin e të drejtës themelore të njeriut për një mjedis të shëndoshë dhe të luajë një rol aktiv në njohjen e burimeve themelore natyrore, ndërsa organet kompetente të mbrojnë dhe ruajnë këto burime të cilat janë rrënjësore në jetën e njeriut për brezat e ardhëshëm dhe sotëm.

Problem serioz mbeten edhe mbetjet urbane ,reciklimi dhe trajtimi i meturinave, prerja dhe shfrytëzimi i pakriterit të pyjeve apo edhe i shtretërve të lumenjve të cilat shkaktojnë çënim dhe shkatërim të biodiversitetit.

Ajo që i duhet shtetit tonë domosdoshmërisht është që të harmonizojë legjislacionin vendor me atë ndërkombëtar me ligjet më të fundit si dhe të observoj politikën e luftimit të krimit kundër ambientit të cilat shtetet e perëndimit kanë arritur sukses që këto ligje sa më mirë të funksionojë në realitet sepse ajo që ndodhë shpeshë është se e aktet juridike mbeten të drejta fiktive domethënë vetëm në letër.

Organet e qeverisjes kanë për detyrë të marrin masa dhe të planifikojnë fonde për investime në pyje, në territorin që mbulojnë, për përmirësimin dhe planifikimin e mbledhjes dhe promovimit të pajisjeve të reja të përpunimit dhe tregimit të produkteve pyjore.

Shteti duhet të mbështet nismat individuale a kolektive të njësive të qeverisjes vendore për rritimin e sipërfaqes së pyjeve, për ripyllëzimin e tokave të braktisura, të zhveshura, të shpyllëzuara dhe të gërryera, në pronësi të tyre, nëpërmjet sistemit të kredive me kushte lehtësuese.

Kurse ajo që konsiderojmë si më primar është ndarja e fondeve për ngritjen e vetëdijes së popullsisë për rëndësinë e këtyre krimeve me anë të reklamave të ndryshme në media dhe portal, vetëm në këtë mënyrë mund të bëjnë qytetarë të bashkëpunojnë me organet e ndjekjes dhe të rritet numri i rasteve të paraqitura, kurse organizatave joqeveritare të ofrohen mbështetje nga ana e qeverisë në realizimin e të drejtave të tyre. Gjendja mohuese e publikut ose informimi i saj i pjesshëm i mediave mbi çështjet që prekin mjedisin, përfshirë dhe mjedisin në Maqedoni është sot një problem që lidhet jo vetëm me nevojën e njohjes së tij, por edhe me vetëdijësimin e publikut për rëndësinë e ruajtjes së tij. Promovimin e Gazetarisë së gjelbërt ose të ashtuquajtur

ndryshe, gazetaria mjedisore, ka të bëjë me identifikimin, raportimin dhe përcjelljen në publik, të mjedisit çështje që prekin shoqëritë e njeriut në ditët e sotme. Në mënyrë të përmbledhur, nga llojet e temave që trajton, kjo lloj gazetarie përqendrohet më së shumti në ngrohjen globale dhe ndikimin e saj në habitatet natyrore si dhe në evokimin e ruajtjes së biodiversitetit ose shumëllojshmërisë së botës së gjallë.

Kurse organet e drejtësisë duhet të shqiptojnë më shumë dënime në rastet e krimit kundër mjedisit jetësor që dënimi të realizojë qëllimin e preventivit të vet në shoqëri, sepse ajo është e njohur me qytetarët që për këtë lloj kriminaliteti ose dënoshesh janë të lehta ose jo dënoshesh fare. Në Ministrinë e Punës së Brendshme nuk ka një organ specifik që merret me ndjekjen e këtyre kriminelëve, por ato janë në kuadër të inspektorëve të krimit ekonomik, në Shtetet e Bashkuara është krijuar një njësi e veçantë e cila merret vetëm me ndjekjen e krimeve kundër ambientit jetësor dhe natyrën me emrin EPA janë njerëz të trajnuar posaçërisht për këto krime të tilla, në mënyrë më profesionale mund të ndjekin këto kriminele, do të ishte shumë mirë në rastet edhe këtu formohet një grup i trajnuar posaçërisht për këto krime.

Njeriu duke vënë në përdorim të pa matur dhe të pakontrolluar burimet dhe të mirat natyrore ka pasuar me shumë fatkeqësi dhe katastrofa natyrore. Sidomos në vendbanime urbane kërkesa të vazhdueshme për strehim dhe infrastrukturë në kuadër zhvillimit dhe aktivitetit urban kanë vënë presion të madh mbi mjedisin e qyteteve. Zhvillimi urban ndryshon tokën, rrjedhjen e ujit, cilësinë e ujit dhe cilësinë e ajrit. E ardhmja e qyteteve tona varet nga aftësitë tona për të ruajtur dhe për të përdorur burimet tona me mençuri (Botkin dhe Beveridge, 1997).

Duke u nisur nga vitet e 90-ta zhvillimet dhe përparimet e hovshme që ndodhën në vendet e zhvilluara duke nisur nga ngritja e nivelit të arsimimit, lidhjet tregtare të shpeshta zhvillimet industriale nëpër qytete ka rezultuar në një lëvizje të madhe të popullsisë nga fshatrat drejt qyteteve si dhe nga qytetet e vogla drejt të mëdhave. Si rezultat i saj qytetet e mëdha sikurse edhe qytetet e Rajonit të Pollogut kanë hasur probleme me mjedisin (dotja e ajrit, ujit, tokës), e gjithë kjo ka sjellë një nevojë urgjente për menaxhim të qëndrueshëm me mjedisin.

Por si mundet njeriu të ju përshtatet këtyre ndryshimeve të hovshme të mjedisit dhe botës në përgjithësi për këtë autori Indonezian Sudarmadi thotë Njerëzit kanë nevojë për edukim të vazhdueshëm, sidomos në fushën e mjedisit, për shkak se mjedisi ka përparuar me shpejtësi. Për arsye se mjedisi luan një rol shumë të rëndësishëm në formimin e personalitetit dhe në këtë

mënyrë më së miri mund të ju përgjigjina ndryshimeve globale që ndodhin në mjedisin jetësor. Që të mund të ju përballojnë dhe të jenë imun gjeneratat e ardhëshme ndaj këtyre ndryshimeve duhet që për çështjet e mjedisit të mësojnë nëpër shkolla, kjo mënyrë është më së e nevojshme por edhe e detyrueshme .

Mbrojtja e pronave dhe aseteve të tokës, si mbrojtja e cilësisë së ajrit dhe ujit, duhet të jetë një qëllim themelor i politikës kombëtare mjedisore (Abdal dhe Suleiman, 2002). Duke iu përshtatur nevojës së kohës shteti jonë duhet të kontrollojë urbanizimin dhe përdorimin e tokave bujqësore si dhe të zhvillojë politika duke pasur parasysh praktikën e vendeve evropiane për menaxhimë me tokën bujqësore. Ruajtja e cilësisë së ajrit duhet të jetë një prioritet nga të gjitha subjektet, formimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm në atë mënyrë që mos dëmtohet mjedisi kurse të rritet niveli i jetesës.

Komunat në planet e tyre duhet të mundohen të parandalojnë ndotjen vizuele ,me ndotje vizuele në përgjithësi i referohet atyre elementëve të peisazhit që është jo tërheqëse, duke përfshirë ndërtesat, shenjat e biznesit, dritat ,rruga, mbeturinat, urbanizimi i paorganizuar dhe mungesa e zonës së gjelbër (Önder dhe Konaklı, 2002). Kurse për të parandaluar këtë fenomen është e preferueshme të ndërtohen sipërfaqe të gjelbëruara dhe parqe. Në mënyrë që mbrohem nga ndotja dhe zhurma parcelat e tregut apo pazaret dhe objektet tjera si shkolla, zonat industriale duhet të rrethohen nga pemë dhe bimë tjera.

Duke pasur parasysh se në Rajonin e Pollogut popullsia dhe ndotja e ajrit janë në rritje ,duhet nga ana e organeve kompetente të meren masa konkrete në lidhje me përmisimin e cilësisë së ajrit që thithin banorët e këtyre rajoneve posaqërisht banorët nëpër qytete ,mungesa e ujit të pijshëm në kohën moderne dhe duke pasur malin Sharrë kaq afër është për këtë rajon nuk duhet të jetë brengosës vetëm duhet të punohet dhe vullnet politik nga ana e komunave, kurse për energjinë të cilën e shfrytëzojnë banorët dhe ndotin aq shumë ajrin nuk do të ishte brengosje në qoftë se shteti promovon burimi të ripërtëritshme të energjisë së pastër ,sic është biogasi ,energjid e erës si dhe panelet diellore.

Tetovës me do e mos i duhet që në afat sa më të shkurtë të pajiset me autobus urban kurs të zhvillojë programe për modernizimin e automjeteve vendosje të kriterëve mjedisore për taksit si dhe automjeteve private. Kurse sa i përket numrit të madh të veturave të sjellura nga jashtë

duhet të vëndohet tatim më i lartë për ato vetura të cilat shkaktojnë më shumë ndotje, mirpo sa i përket fabrikës “Jugohrom Ferrolloys” e cila mendohet të jetë shkaktari më i madh i ndotjes së ajrit nuk duhet lejuar të funksionoj pa i përmbushur standartet ekologjike të vendosura nga qeveria.

Në situatat aktuale përgjigja e instucioneve ndaj krimit ekologjik në vendin tonë nuk ka pasur aspak sukses, ministria e punëve të mbrendshme si dhe ministria e mjedisit kanë dështuar në luftën kundër krimit ekologjikë ,kurse gjykatat janë treguar të pa fuqishme me kto raste dhe larg kapacitetve profesionale gjatë trajtimit të këtyre krimeve. Duke pasur parasysh se me mjedis kuptojmë dhe përfshihet aspektet ekonomike ,sociale dhe jetike duhet angazhim dhe seriozitet ndaj këti fenomeni i cili po mer shumëjetë njerzish dhe po pamundëson nevojën themelore të njeriut për një natyr të pastër dhe cilësore.

BIBLIOGRAFIA

- Murtezan Ismaili-Bujar Durmishi ,Shoqëria dhe menaxhimi i mbrojtjes së mjedisit,Tetovë 2006
- Azis Pollozhani,Ekologjia humanedhe shëndeti publik, Shkup 2009
- Latifi Vesel, Politika kriminale, Prishtinë 2008;
- Halili Ragip, Kriminologjia, Prishtinë 2011;
- Halili Ragip, Viktimologjia, Prishtinë 2007;
- Halili Ragip, Penologjia, Prishtinë 2000;
- Piers Beime,Nigel south,Issues in Green criminology:Confronting Harms Against Eenvironments,Other Animals and Humanity, 2007
- Rob white ,Crimes agains nature,Enviromental CRIMINOLOGY AND ECOLOGICAL JUSTICE, UK 2008
- Veselin Peculi,Hysen Mankolli,"Ekologjia e zbatuar",Tiranë 2005
- Vllado Kambovski,"E drejta penale",Shkup 2006
- Barnes,N.,”Conficts over biodiversity”,Cmbridge 1996
- Ismail Zejneli,”E drejta penale,pjesa e posaqme”,Tetovë 2007
- I.Elezi,V. Hysi,"Politika Kriminale",PEGI, Tiranë
- Modly, Korajliq, 2002
- Konventa e këshillit të Evropës “Mbi mbrotjen e mjedisit nëpërmjet të drejtës penale” Council of Europe ETC No.172, Strasbourg, 04.09.1998
- Gurbardhi, A “Sfidat ekologjike dhe krimi ne fushën e ambientit”, Gazeta “Metropol” (2005)
- Mirsad Abazovic,”Politika e Luftimit të kriminalitetit”, Sarajevë-Prishtinë 2006
- Eric Lichtfouse,” EditorOrganic Farming, Pest Control and Remediation of Soil Pollutant”,Frace 2008 “
- William P.Cuningham&Mary Cuningham -“Environmental Science - A Global Concern 12th Edition”

- Ibrahim A. Mirsal, "Soil Pollution Origin, Monitoring & Remediation"
- Milana Pisari, "Luftimin ndërkufitar i krimit mjedisor" Beograd
- Ristevski K. Davidovski B., "Ekolosko pravo", "Studentski sbor" Shkup, 1997

BURIME JURIDIKE

- Kushtetura e Republikës së Maqedonisë;
- Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë;
- Ligji për kundërvajte i Republikës së Maqedonisë
- Ligji për pastërti publike